



Gazeta Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXIV i botimit, nr. 269, mars 2026

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

TË RIKTHEHET FIGURA E MËSUESIT

Nga FRAN GJOKA

Pavarësisht shqetësimeve që ka arsimit shqiptar, mësuesi ka qenë figurë mjaft e respektuar në të gjitha periudhat e historisë njerëzore, si një person me shumë influence jo vetëm pedagogjike, por edhe shoqërore, ishte një figurë e nderuar dhe e respektuar nga mbarë opinionin publik, sidomos nga masa e rinisë, prindërit dhe nga nxënësit e shkollës. Nodonte kjo, pasi ai ishte misionar i kulturës dhe diturisë, personi që përhapte dije dhe kulturë në mbarë vendin. Mësuesi përgatiste brezat, njerëzit që do t'i dilnin zot fateve të atdheut. Këtë mision mësuesit e kanë përfunduar me sukses në kohë të ndryshme, duke punuar gjithmonë me përkushtim për të realizuar me sukses detyrat dhe misionin e tyre fisnik. Po nëse respektohej nga shoqëria në të kaluarën, mësuesi i sotëm nuk vlerësohej në nivelin e duhur nga shteti totalitar, sepse veç punës mësimore, përgatitjes ditore, aktivitetit me nxënësit, mësuesi i duhej shtetit në fuqi për të përçarur vijën politike të partisë-shtet. Në këtë pikëpamje, mësuesi në të kaluarën që një shërbëtor i sistemit në fuqi, dinjiteti i tij që i nëpërkëmbur, pasi emërohej, shkarkohej dhe madje edhe kontrollohej nga një burrë i inkompetentë pushtetarë dhe pa asnjë asaj kohe.

KUR SIMBOLI ZËVENDËSON PËRMBAJTJEN!

Kur simboli zëvendëson përmbajtjen:
një reflektim për 8 Marsin!

Si psikologe, 8 Marsin, Ditën Botërore të Gruas nuk e shoh vetëm si një ditë urimesh apo simbolesh, por si një moment reflektimi mbi mënyrën se si shoqëria jonë ndërton dhe përjeton respektin ndaj grave. Kjo ditë ka lindur nga një histori e gjatë përpjekjesh: nga zërat e grave që për shumë kohë nuk u dëgjuan, nga sakrificat dhe nga lufta për të drejta që sot na duken të natyrshme. Megjithatë, me kalimin e viteve, shpesh duket sikur kuptimi i saj është reduktuar në gje të simbolit të tufë mimozash...

Disa këndvështrime për Poetin Frederik Rreshpja, Mjeshtër i Madh!

6

Pjesëmarrës në tryezën shkencore kushtuar Frederik Rreshpes, në përvjetorin e 20-të të ndarjes nga jeta (3 mars 2026, Ora: 10.00, Salla «Akademikët» (Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhës dhe i Letërsisë, Departamenti i Studimeve Letrare).

Referimi, me temë:

“DISA KËNDVËSHTRIME PËR POETIN FREDERIK RRESHPJA”,
nga shkrimtari XHAHID BUSHATI

Të nderuar studiues, krijues, pedagogë e miq të pranishëm,

Gjatë leximit, rileximit dhe studimit të krijimtarisë së poetit Frederik Rreshpja në vite dhe në kohë, edhe sot ruaj të njëjtin mendim se, Rreshpja është një figurë, ende, e pa ndriçuar e kontradiktore në rrafshin studimor e social. Ndaj, unë, për zemërsisht falënderoj organizatorët e kësaj veprimtarie shkencore, në veçanti për prof. Evaldën, për ftesën e bërë; që janë kujtuar për këtë figurë të nderuar, veçanërisht poetike, që la një krijimtari të pasur, si në poezi, roman, dramë, ese dhe mendime filozofike, letërsi për fëmijë... e të tjera. Sigurisht, dialogu, mendimi dhe kuvendimi në këtë veprimtari dobi-prurëse do të ndriçojë më tej figurën e Rreshpes...



HISTORIA E PSIKIATRISË SË SHQIPËRISË

Prof. Dr. Luljeta Pula

Në shenjë respekti dhe nderimi për punën e përkushtuar shkencore, pedagogjike, mjekësore dhe për veprimtarinë e dendur botues të Mjekut tim, Njëshit të Psikiatrisë Shqiptare andej dhe këndeje kufirit, Prof. Dr. Vuksan Kolës, me rastin e daljes në pension

Një libër i Prof. Dr. Vuksan Kolës, që më mrekulloj! Mbeta vërtetë e mrekulluar dhe shumë e impresionuar nga ky libër i mjekut tim të shtrenjtë, Prof. Dr. Vuksan Kolës, që mban titullin "HISTORIA E PSIKIATRISË SË SHQIPËRISË"! Një punë kolosale dhe shumë e rëndësishme e me shumë vlerë! Një testament kaq i çmuar për gjeneratat e ardhshme, i historisë njëshekullore të Psikiatrisë së Shqipërisë! Një punë aq serioze, grandioze dhe analitike për rrugëtimin historik të psikiatrisë shqiptare meriton çdo vlerësim, çdo nderim dhe respekt! Ky ishte vetëm njeri nga shumë librat e profesorit të nderuar, të botuar ndër vite, për të cilat nuk isha në dijeni. Duke lexuar librin, e para që më shkoi ndërmend ishte ideja se mbase edhe ndonjë nga psikiatritë e Kosovës do të mund ...

HISTORIA JONË KOMBËTARE, PROPAGANDISTËT NEO - OTOMANE DHE HISTORIANËT TURQ

Nikoll Loka

Historian dhe publicist

Po ta trajtojmë në mënyrë konceptuale dhe akademike qëndrimin e "historianëve" neo-otomanë që vijnë të na imponojnë narrativën e tyre të pushtimit dhe sundimit të territoreve shqiptare, del se ata kanë mendësi neo-koloniale...

Ka një parim të pashkruar ...

TË RIKTHEHET FIGURA E MËSUESIT



Nga FRAN GJOKA

Pavarësisht shqetësimeve që ka arsimit shqiptar, mësuesi ka qenë figurë mjaft e respektuar në të gjitha periudhat e historisë njerëzore, si një person me shumë influence jo vetëm pedagogjike, por edhe shoqërore, ishte një figurë e nderuar dhe e respektuar nga mbarë opinioni publik, sidomos nga masa e rinisë, prindërit dhe nga nxënësit e shkollës. Ndodhte kjo, pasi ai ishte misionar i kulturës dhe diturisë, personi që përhapte dije dhe kulturë në mbarë vendin. Mësuesi përgatiste brezat, njerëzit që do t'i dilnin zot fateve të atdheut. Këtë mision mësuesit e kanë përfunduar me sukses në kohë të ndryshme, duke punuar gjithmonë me përkushtim për të realizuar me sukses detyrat dhe misionin e tyre fisnik. Po nëse respektohej nga shoqëria në të kaluarën, mësuesi i sotëm nuk vlerësohej në nivelin e duhur nga shteti totalitar, sepse veç punës mësimore, përgatitjes ditore, aktivitetit me nxënësit, mësuesi i duhej shtetit në fuqi për të përçarur vijën politike të partisë-shtet. Në këtë pikëpamje, mësuesi në të kaluarën qe një shërbëtor i sistemit në fuqi, dinjiteti i tij qe i nëpërkëmbur, pasi emërohej, shkar-kohej dhe madje edhe kontrollohej nga njerëz inkompetentë pushtetarë dhe partiakë të asaj kohe.

Kam punuar si mësues dhe kam fituar një përvojë rreth 50 vjeçare në arsim, e kujtoj mjaft mirë atë kohë të vështirë, kur mësuesi pasi kishte ecur disa orë rrugë në këmbë, kryente gjashtë orë mësim, madje shpesh edhe me klasa kolektive, shkante në brigadë ose kolektiv punonjësish për të referuar tema politike ose sociale pa asnjë lloj vlere, përgatiste dhe zhvillonte temat fiktive të formave të edukimit në parti, pa asnjë lloj motivimi ose shpërblemi dhe kthehej në shtëpi i sflitur për të kryer përgatitjen ditore për të nesërmen. Ndërsa për detyrime shoqërore apo familjare nuk diskutohej fare dhe as që mendonte njeri se mësuesi i gjerë kishte detyrime të tilla, siç kanë të gjithë njerëzit në shoqëri. Më e keqja është se edhe sot po ndodh pikërisht kështu. Figura e nderuar e mësuesit sot, jo vetëm që nuk vlerësohet, por për më tepër duket se urrehet. Mësuesit sot i duhet të përballojë një stres të jashtëzakonshëm, që i vjen nga të gjitha anët. Duke ditur se mësuesi luan rol me rëndësi, por siç thotë një fjalë urtë, "Mësuesi të hap derën, por duhet të hysh vetë brenda". Puna është se edukatorët e sotëm të brezit të ri, nuk

po mundin ta hapin si duhet derën për nxënësit. Na mbyten militantët e partive. Çfarë punë kanë militantët në shkollë!? Ç'hyjnë bindjet politike në procesin mësimor!? Gjithë drejtorët e shkollave dhe ata rajonalë apo vendor janë militantë. Por jo vetëm kaq, mbi të gjitha janë të paaftë dhe s'kanë treguar kurrë veten në asnjë fushë të kërkimit shkencor apo pedagogjik. Në shumë raste nuk kanë asnjë lidhje me mësimin. Kjo bën që mësuesit e vërtetë, mësuesit profesionistë e të ditur, të ulin kokën, t'u bindën të paafteve. S'kanë rrugë tjetër, pasi ata të hedhin në rrugë, të lënë pa punë. Vendin po e drejtojnë hajdutët dhe kriminelët, ata që dinë të vjedhin, të pacipët, njerëz që nuk e duan Shqipërinë. Të jeni të sigurtë, të nderuar mësues, që na ka mbytur e keqja, mediokriteti është ulur këmbëkryq. Vlerën e ka marrë paraja, mendja është lënë mënjanë. Kaq poshtë ka rënë shkollimi për këtë profesion fisnik, sa në degën e mësuesisë shkojnë nxënësit më të dobët, pasi kërkesa në mësuesi është tepër e ulët, ku dhe pagat e mësuesve janë nën nivelin mesatar, kur në perëndim është sot nga profesionet më të paguara. Ka ardhur koha të arrijmë

notë më të lartë, madje edhe vetë nxënësit si pa të keq e kundërshtojnë, e kërcënojnë dhe debatojnë me mësuesin, sepse nuk u pëlqen kultura, mësimi dhe edukata që mësuesi u sugjeron atyre në forma të ndryshme. Dhe përsëri heshtja vazhdon. Hesht shteti, hesht shoqëria, hesht drejtorja, hesht prindi, por nuk hesht nxënësi, i cili nuk pyet fare se shkolla është vendi ku mësohet dhe edukohet njeriu, por bën ç'të dojë, madje edhe në orën e mësimin. Ndodh kjo, sepse nuk kemi ligje për të ndëshkuar edhe minimalisht fajtorët pra, nxënësit apo prindërit që bëjnë veprime antipedagogjike, antishoqërore, ndërsa mësuesin një gabim të vogël po të bëjë e "kap" ligji, e denoncojnë te "Fiksi" e "Stopi", e pushon dikasteri dhe askush nuk e mbron, si pati, si nuk pati të drejtë.

Në ditët e sotme, disa nxënës shkojnë në shkollë për t'u dëfryer, sepse shumica prej tyre nuk mësojnë, nuk lexojnë fare, nuk e dëgjojnë mësuesin, nuk aktivizohen në mësim apo në diskutime mësimore, nuk shkruajnë detyrat që u rekomandon mësuesi, aq më tepër se sot disa shkolla përpiqen të bëjnë mësim online, që për hir të së vërtetës duhet theksuar se efek-

asnjë masë disiplinore. Në këto kushte, gjendja është e vështirë të ndryshojë. Probleme të tilla ka kudo në vendin tonë dhe për çudi as shoqëria jonë nuk e ngrë zërin kundër këtyre fenomeneve negative dhe as institucionet shtetërore nuk marrin masa për të parandaluar këto dukuri. Është totalisht e dhimbshme të shohësh një brez të ri që nuk përgatitet për jetën sot kur është momenti i duhur për ta bërë një gjë të tillë, ku pasojat e kësaj gjendje, do t'i shohim pas pak vitesh, të shohësh një mësues, intelektual, pjesëtar i kësaj shoqërie të civilizuar në këtë gjendje shoqërore, psikologjike dhe ekonomike, siç është kandidateur kjo figurë e nderuar e shoqërisë sonë, vërtetë të len për të dëshiruar.

Në biseda dhe diskutime të ndryshme më thonë se profesioni i mësuesit është bërë i bezdisshëm për shumë arsye, sidomos për mësuesit me klasa kolektive në arsimin parauniversitar, të cilët detyrohen të bëjnë 12 orë mësimi dhe të përgatisin edhe 12 orë përgatitje ditore në ditë, një punë e mundimshme për vendosjen e së cilës mbi baza metodike dhe pedagogjike nuk mendon askush. Ndërkaq mësuesi është i detyruar që me mjeshtërinë, për-



urgjentisht objektivin për ta parë mësuesin si pasqyrë e të ardhmes së kombit. Ai është objekt kritikash nga politika, ministria, Drejtoritë Rajonale, ZA, Drejtoritë e shkollave, njësitë vendore dhe bashkitë, prindërit, madje edhe nga vetë nxënësit, të cilët tani e përçmojnë mësuesin, duke treguar hapur se nuk janë fare të interesuar për mësim dhe as për edukimin e tyre. Asnjë shoqatë, asnjë institucion, asnjë ligj nuk kemi deri tani që të mbrojnë dinjitetin e këtij intelektual, madje edhe të ashtuquajturat Sindikata të Arsimit e kanë braktisur atë. Kush hyn dhe del në dyert e shkollës, kërcënon vetëm mësuesin, e kërcënon kontrolluesi me pushim dhe ndëshkim financiar, e kërcënon inspektori, kontrolluesi, i bën presion psikologjik prindi pse nuk ka vlerësuar nxënësin me

tiviteti i këtij mësimi është tepër minimal. Nxënësit sot janë të prirur pas zhurmës, pas anomalisë, përdorimit të telefonit celular, lojërave dhe diskutimeve të pavlera, largohen pa leje për në pabe, ku konsumojnë alkool, duhan, në mos përdorin edhe lëndë narkotike, stimulojnë grindje, ngatërresa, madje edhe deri në përdorimin e armëve të ftohta etj. Shpesh, në këto aktivitete të prapta, ata ndihmohen edhe nga keqbërësit e grupet kriminale. E ç'mund të bëjë mësuesi në kushte të tilla? Ai është totalisht i paaftë të veprojë, sepse nuk ka në dorë një rregullore, udhëzim apo ligj që në këto raste ndëshkon fajtorët. Në shkollat e mesme dhe të larta ky problem është i zgjidhur, megjithëse pak masa merren, po problemi qëndron tek arsimi parauniversitar, ku nuk mund të marrësh

vojën, aftësinë, fleksibilitetin pedagogjik të krijojë kushtet normale dhe "situata të ndryshme pedagogjike", në të cilën nxënësi të ketë mundësi të zgjedhë alternativa veprimi, kulturimi në përputhje me dëshirat, aftësitë dhe prirjet e tij personale. Kjo liri pedagogjike, nuk ka pse të jetë e huaj për shkollën tonë moderne, nëse mësuesi dhe nxënësi dinë të respektojnë njëri-tjetrin, duke luajtur secili rolin e vet. Me fjalë të tjera, ka ardhur koha që në shkollë të punojmë, që, duke e demokratizuar atë dhe marrëdhëniet midis mësuesit dhe nxënësit nga njëra anë, po kaq seriozisht të mendojmë për një "rikonceptim të roleve" dhe statusit të secilit, si mjet për mbarëvajtjen e punës dhe procesit mësimor dhe edukativ në shkollë. Çështja e njohjes dhe

Kur simboli zëvendëson përmbajtjen!

Kur simboli zëvendëson përmbajtjen: një reflektim për 8 Marsin!

Si psikologe, 8 Marsin, Ditën Botërore të Gruas nuk e shoh vetëm si një ditë urimesh apo simbolesh, por si një moment reflektimi mbi mënyrën se si shoqëria jonë ndërton dhe përjeton respektin ndaj grave. Kjo ditë ka lindur nga një histori e gjatë përpjekjesh: nga zërat e grave që për shumë kohë nuk u dëgjuan, nga sakrificat dhe nga lufta për të drejta që sot na duken të natyrshme. Megjithatë, me kalimin e viteve, shpesh duket sikur kuptimi i saj është reduktuar në gjeeste simbolike: një tufë mimozash, një urim i shpejtë apo një postim i bukur në rrjete sociale. Nga një këndvështrim psikologjik, kjo nuk është e pazakontë. Njerëzit kanë një prirje të natyrshme për të përdorur simbole dhe rituale për të shprehur vlerat e tyre. Një lule, një urim apo një festë mund të jenë forma të vogla të mirënjohjes. Por problemi lind kur simboli zëvendëson përmbajtjen. Sepse respekti nuk është një gjest që shprehet vetëm një herë në vit. Respekti është një qëndrim i përditshëm. Ai reflektohet në mënyrën si flasim për gratë, në mënyrën si i dëgjojmë, në hapësirën që u japim për të shprehur mendimin e tyre dhe në mundësitë që shoqëria u ofron në familje, në punë dhe në jetën publike. Si psikologe, shpesh vërej një paradoks në shoqërinë tonë: ne dimë të festojmë shumë mirë simbolin, por jo gjithmonë arrijmë ta jetojmë thelbin çdo ditë. Ndonjëherë një gjest simbolik – një lule apo një urim – na bën të ndihemi mirë me veten, edhe kur sjelljet e përditshme nuk përputhen plotësisht me atë mesazh. Por filozofia e kësaj dite është shumë më e thellë se kaq. Barazia, respekti dhe dinjiteti nuk duhet të jenë vetëm një kujtesë simbolike në kalendar. Ato duhet të jenë një kulturë që ndërtohet çdo ditë: në gjuhën që përdorim, në qëndrimet që mbajmë dhe në mënyrën se si i trajtojmë njëri-tjetrin. Sepse një shoqëri e drejtë nuk matet nga lulet që dhuron në një ditë të vetme, por nga respekti që di të kultivojë çdo ditë në jetën e përbashkët.

Psokolgia Suela Ndoja

RESPEKTI NUK ËSHTË NJË GJEST. ËSHTË NJË QËNDRIM I PËRDITSHËM.

1

Në GJUHËN që përdorim

Faleminderit, Të dëgjoj, Të dëgjoj, Të dëgjoj.

Faleminderit, të dëgjoj.

2

Në qëndrimet e dëgjimit

Dëgjoni gratë, jepuni hapësirë.

3

Në mundësitë që ofrojmë

Në familje, në punë, në jetë publike.

4

Si e trajtojmë njëri-tjetrin

Dinjteti dhe barazia si KULTURË.

Një shoqëri e drejtë nuk matet nga lulet që dhuron në një ditë, por nga respekti që kultivon çdo ditë.

Reflektim nga një Psikologe.

respektimit të statusit të mësuesit dhe nxënësit ndikon në krijimin e një atmosfere të veprimit të “hierarkisë shkollorë”, e cila është e domosdoshme për një institucion të tillë, me mision social, didaktik dhe pedagogjik, siç është shkolla. Nëse do të arrijmë që në shkollë të kemi përfytyrime të drejta për statusin e mësuesit dhe nxënësit, sanksionuar me ligj, duke respektuar të drejtat institucionale të secilit, atëherë kemi për të pasur një atmosferë marrëdhëniesh të mirëkuptimit reciprok. Kjo është ajo që i duhet shkollës, për të pasur efikasitet dhe efikasitet socio-pedagogjik, rezultate të prekshme dhe gjurmë të thella të relacioneve shpirtërore midis mësuesit dhe nxënësit. Nuk ka pse të ngatërrojmë shkollën me koncepte të skajshme konservatore, arkaike të pedagogjisë së vjetër e të re, që janë provuar se kanë qenë dhe janë antiproduktive, të panatyrshme për shkollën moderne shqiptare, në stadin e sotëm të zhvillimit. As nxënësi, por as mësuesi nuk janë ata që kanë qenë dikur, as marrëdhëniet e tyre nuk ndërtohen mbi parime të vjetra që ngatërrojnë “statuset reciproke”, që dëmtojnë punën e shkollës. Me të drejtë mësuesi shihet si prind i dytë për fëmijët e shkollës, pasi dëshira e tyre është e madhe dhe një pjesë të kohës e kalojnë së bashku. Problemet që hasin në udhëtimin e gjatë të jetës, fëmijët e ndajnë me mësuesit e tyre, pasi me ta ndihen të lirshëm dhe të sigurte, por vlerësimi për këtë profesion fisnik është i paktë.

Asnjëherë shkolla nuk është normale, nëse nuk ka të kristalizuar misionin, qëllimin, funksionin dhe natyrisht edhe statusin dinamik të dy figurave të përjetshme të saj: mësuesit dhe nxënësit.

Mësuesit, në ditët e sotme, përsëri sakrifikojnë me mundim të madh. Mësuesi detyrohet të hartojë plane, të përgatisë tema shkencore dhe sociale, të hartojë projekte ekstra, të redaktojë tekstet shkollorë, të hartojë skenarë për aktivitetet të ndryshme, të plotësojë relacione informative, të përgatisë informacione për prindërit, të ndjekë kurse të detyrueshme dhe të blejë kredite profesionale me paratë e rrogës së tij të vogël. Besoj, nga sa thashë më sipër, nuk mund të gesh institucion më të ngarkuar dhe më të vështirë dhe, për më tepër, as reforma nuk po i prek këto çështje, megjithëse thuhet se mësuesi do të shkarkohet nga çështjet burokratike, megjithatë po tregohet e kundërta. Për këtë arsye, sot shoh mësues të lodhur, të stresuar, të dërrmuar, mësues që ditë-ditë po u zbehet dëshira për punë, për të cilët askush nuk po interesohet. Ka vite që është miratuar udhëzimi për të mos përdorur celularin gjatë kohës së punës në shkollë dhe u bë shumë mirë. Po nëse nuk duhet ta përdorë mësuesi për asnjë lloj arsye telefonin, sepse për të mund të merrret edhe masë ekstreme disiplinore, si do të vepronet me nxënësit, sidomos në arsimin parauniversitar, që e përdorin masivisht, madje edhe brenda orës së mësimin dhe mësuesi nuk ka asnjë bazë

ligjore për të marrë masa ndaj këtij fenomeni shumë të përhapur në shkollat tona. Mendoj se ashtu siç mund të ndëshkohet mësuesi, duhet të merren masa edhe ndaj nxënësit, pasi ai është një mjet që dëmton rëndë normalitetin e orës së mësimin. Si pjesë e kësaj shoqërie, edhe mësuesit meritojnë vëmendje më të madhe jo vetëm në përmirësimin e pozitës sociale dhe shoqërore, por edhe në trajtimin ekonomik. Kam shumë shokë dhe miq mësues që punojnë në sistemin arsimor dhe të gjithë ankohen, të gjithë kanë marrë kredi nëpër banka të ndryshme për të jetuar, overdraftët e tyre nëpër banka janë zero, madje edhe shpërblimet jepen në mënyrë selektive, por masa e madhe e mësuesve tanë nuk janë mësuar me salltanete, ata janë njerëz të thjeshtë, që jetojnë vetëm me punë, me vështirësi. Kam shumë miq mësues që kanë dalë në pension kohët e fundit. Është absurde të punosh rreth 43 vjet mësues, të kesh shkrirë gjithë aftësitë dhe energjitë tuaja për edukimin e brezit të ri dhe vlerësimi për këtë punë plot përkushtim dhe sakrificë, të jetë zero. As shteti dhe as instancat përkatëse nuk interesohen për këtë figurë të ndritur. Mësuesi kalon rreth gjysmën e jetës së tij në profesion dhe nuk stimulohet fare, nuk shpërblehet për punën e bërë, qoftë një ertifikatë mirënjohjeje t’i jepet nga dikasteri qëndror, mirë do të ishte. Shteti ynë dhe Presidenti i Republikës po dekorojnë persona me dhe pa merita, po japin tituj dhe vlerësime pa doganë,

po mësues asnjë, sikur ata vetë nuk kanë dalë nga duart e mësuesve, sikur nuk kanë dalë nga bankat e shkollave. Është e papranueshme që një mësues, i cili del në pension, ta mbyllë bilancin me borxhe, ndryshe nga disa profesione ose pozicione të larta shtetërore që po venë pasuri dita-ditës. Është momenti që në këtë 7 Mars të sensibilizojmë organet shtetërore, ekzekutive dhe shoqërore të jenë më të vëmendshëm ndaj mësuesit, punës së tij dhe trajtimit të tij shoqëror, institucional dhe material. Nuk është e mjaftueshme të flasim vetëm dy herë në vit për këta misionarë të dijes në rang institucional, vetëm në shtator kur fillon viti i ri shkollor dhe me 7 Mars, ku i mbushim me lëvdata dhe fjalë të mira, po të marrim masa që të ndryshojnë jetën dhe veprimtarinë e tyre pedagogjike, me qëllim që kjo shtresë e shoqërisë sonë të jetë në nivelin e detyrave që shtron sot koha. Pra, edhe kur kanë festën e tyre, mësuesit nuk gëzojnë. Në këto kushte, nëse nuk ndryshohet pozita e tyre shoqërore, problemet në shkollat tona mund të përshkallëzohen dhe gjendja të përkeqësohet akoma më shumë. Nesër do të jetë vonë...Këtu ja vlen të kujtoj disa vargje nga poezia e poetit të njohur, Lllazar Siliqi “Mësuesi”: “... Edhe kur kryet do na e mbulojnë thinjat, / ndërmend do të sjellim një emër nderues, / emrin e dashur, emrin e bukur, / emrin e thjeshtë, por të madh, Mësues...”

Le të jenë si lejtmotiv për të ardhmen, vargjet e këtij poeti të madh...

Leku - Emër, histori dhe dinjitet!

Më 13 shkurt 1922, në një sallë Kuvendi pa tym e pa brohoritje, Shqipëria i dha vetes një emën monetar, që nuk kishte nevojë për huazime perandorake ..

Kryeministri i kohës, Pandeli Evangjeli, e hodhi propozimin.

Profesori Bahri Omari bani pyetjen e drejtë, pyetjen që i takon dijes: Prej nga vjen ky emën? Dhe përgjigjja erdhi e kthjellët, pa mjegullime romantike.

- Vjen prej emnit të Lekë Dukagjinit. Lek. Jo si rastësi. Jo si trillim. Por si zgjedhje e vetëdijshme. Emën i marrë prej Lekë Dukagjinit, njeri i ligjit, i besës, i fjalës që nuk thyhet.

U hodh në votim.

U miratue me 25 vota.

Ky Lek nuk erdhi mbi kalë të bardhë, as me ushtri, as me mitologji të importueme. Erdhi si ligj. Si rregull. Si masë. Erdhi si peshë e fjalës shqiptare. Dhe u ba emër monedhe, monedhë.

E kështu, pa tym e pa legjenda të shpikuna, u vulos një akt që i dha Shqipërisë jo veç një monedhë, por një emën me rrënjë. Ky vendim asht aty, në Arkivin e Kuvendit të Shqipërisë, i heshtun si çdo dokument shteti, por i thellë si çdo vendim që mbijeton.

Dhe mbijetoi!

Nuk u rrëzue prej regjimesh, nuk u ndërrue prej ideologjish, nuk u prek as prej rrëmujës së tranzicionit. Leku mbeti.

Si një gur kufini mes kohësh.

Rreziku i vetëm real që i kanoset sot lekut nuk vjen prej brenda, por prej jashtë: Evropa. Jo si armik kulturor, por si proces politik. Prej tri dekadash e presim hyrjen në Bashkimin Evropian si një mrekulli që na premtotet, por nuk na shpjegohet as një herë. E them pa ironi mirë se të vijë, por mrekulli s'ka me pas. Mrekullia do të ishte e kundërta me u ba si Zvicra, me lekun tonë, me sovranitet monetar, me dinjitet ekonomik. Por kjo kërkon mendim të thellë, jo iluzione.

Ajo që kurrë nuk iu shpjegue këtij populli asht thelbi simbolik i Lekut. Leku nuk asht thjesht njësi këmbimi. Ai mban emnin e udhëheqësit shpirtënor të shqiptarëve: Lekë Dukagjini, njeri i ligjit, i rregullit, i besës. Kështu u vendos.

Kështu mbeti.

Dhe pikërisht këtu nis keqkuptimi ynë kolektiv. Në vend që ta pranojmë me qetësi, kemi zgjedhë rrugën e fantazisë së zhurmshme: lidhjen me Aleksandërin e Madh të Maqedonisë. Një megalomani imagjinare, një butafori historike, romantizëm folklorik pa shtyllë kurrizore shkencore.

Do të doja edhe unë që Aleksandri i Madh të ishte shqiptar. Por historia nuk ndërtohet me dëshira. Ai nuk ishte ilir. Nuk mund ta bindim botën për këtë, sepse nuk ka as dokument, as dëshmi, as konsensus shkencor. Po, ishte nip i Pirros së Epirit, por nipi nuk mund quhet bir. Ai mbetet veç nip bibe epirote dhe, në shumë rrethana, me babë e katragjysh armik i ilirëve.

Le ta pyesim veten pa emocione: kush

e vrau mbretin ilir Klitin, vetëtimat apo Aleksandri? Historia asht e ashpër; ajo nuk i përkëdhel mitet tona.

Na shqiptarët shpesh nuk pranojmë as të vërtetat tona, prej xhelozisë së katundit, e mandej kërkojmë lavdi në oborret e hueja. Por Leku ynë mban emnin e një shqiptari të madh, një figure që i ban nder

historisë sonë pa pas nevojë për huazime madhështore.

Imitimi i emrave të mëdhenj na ban qesharakë, falsë, të pabesueshëm. Sepse mbarë bota e di se Aleksandri asht Aleksandri i Madh i Maqedonisë. Tue e imitue, humbasim seriozitetin.

Na nuk kemi pse me vjedhë lavdi. Jemi

krejt në rregull, realistë e të besueshëm, t'u themi brezave se sendi ma i çmuem i këmbimit kombëtar mban emnin e Lekë Dukagjinit.

Dhe po, rrjedhimisht, ai emën meriton edhe fytyrën e tij mbi një prerje monetare. Jo për kult, por për kujtesë. Jo për folklor, por për identitet. Sepse monedha nuk asht veç metal apo letër. Ajo asht histori e përditshme që kalon dorë më dorë. Dhe kur ajo histori ka emën të vërtetë, rrënjë të pastra e dinjitet, nuk ka nevojë për mite të huaja.

Leku, burri më i madh i Dheut

Leku është burri më i mirë shqiptar, ashtu si dollari burri më i madh i botës. Leku Zoti i adhurar, por edhe i atyre që paranë e quajnë me emra të tjerë. Për lek nuk na zë gjumi; për lek, sa e sa të etur i ka marrë lumi. Për lek mohohet Zoti, shitet atdheu, nxihet dheu, për lek vëllai të bahet si shkja.

Për lek bëhet lufta dhe paqja; për lek shitet trupi, mohohen nëna e babai, harrohet fisi dhe nxihet faqja. Ky Leku ynë që na lartëson be na bën Tomor, Jezercë e Korab e na gremisë në fund të detit dhe na bën fytyrën shollë këpuce.

Ky leku ynë ë i dashur që mban emrin e një burri, që dikur ishte roja dhe ndera e vatanit. Çdo ditë ia përmendim emrin, e, përkëdhelim, e duam, e ëndërrojmë; qajmë kur na mungon dhe e mallkojmë kur na ikën nga duart.

Paçka fesë, Lekun e duam më shumë se çdo perëndi.

Dashnoret e lekut thonë: - Lum kush e ka! Lekut nuk i vjen era se nga vjen. Për ty, o Lek, dashurohemi dhe bëhemi mercenarë të çdo partie, të çdo kauze, të çdo mashtrimi.

E çuditshme, e marrëzishme dhe e nevertitshme njëkohësisht që për lekun harrojmë e braktisim gjithçka. Pese leku ynë mban emrin e Lekës?

Një emër jo i rastësishëm, por i rëndë si gur dhe i fortë si ligj.

Pse Leka e jo ndonjë tjetër?


Për këtë pyetje, shkoni e pyesni ata që e ligjëruan kështu. Ia vunë këtë emër dhe ashtu i mbeti. Një emër që nuk e djeg flaka dhe nuk e shuan deti. Secili prej

nesh mban një emër që të tjerët na e ngjiten pa na pyetur. Disa emra na rritin, disa na rëndojnë, disa na mbajnë gjallë. Edhe leku ynë mban një emër që peshon histori.

Secili prej nesh e gëzoftë emrin e vet!

Edhe leku ynë e gëzoftë emrin e Lekë Dukagjinit!

Historiani, poeti e publicisti
PRELË MILANI



Artikulli i parë u pranue kështu: Për të lehtësue cirkulimin e të hollave Qeverija autorizohet të presë tre milion frang ari

Këndohet artikulli i dytë si mbas projektit të bashkangjitur.


z. Bahri Omari: Nga u muet fjala Lekë.

z. Kryeministri: Asht marrë nga Lek Dukagjini.

z. Shefqet Daji: Fjala Lekë ka një kuptim jo të mirë në vendin t'onë, prandaj proponoj të thuhet Shqipë.

z. Kryetari: Kush asht antarë që parja e Shqipërisë të quhet Lekë, të ngrehë dorën? Pranohet me 25 vota.

Mbas disa diskutimesh vendohet të shtohet në artikullin 2 që Leka ndahet 100 qin-



HISTORIA E PSIKIATRISË SË SHQIPËRISË



Prof. Dr. Luljeta Pula

Në shenjë respekti dhe nderimi për punën e përkushtuar shkencore, pedagogjike, mjekësore dhe për veprimtarinë e dendur botues të Mjekut tim, Njëshit të Psikiatrisë Shqiptare andej dhe këndeje kufirit, Prof. Dr. Vuksan Kolës, me rastin e daljes në pension

Një libër i Prof. Dr. Vuksan Kolës, që më mrekulloj!

Mbeta vërtetë e mrekulluar dhe shumë e impresionuar nga ky libër i mjekut tim të shtrenjtë, Prof. Dr. Vuksan Kolës, që mban titullin "HISTORIA E PSIKIATRISË SË SHQIPËRISË"! Një punë kolosale dhe shumë e rëndësishme e me shumë vlerë! Një testament kaq i çmuar për gjeneratat e ardhshme, i historisë njëshekullore të Psikiatrisë së Shqipërisë!

Një punë aq serioze, grandioze dhe analitike për rrugëtimin historik të psikiatrisë shqiptare meriton çdo vlerësim, çdo nderim dhe respekt! Ky ishte vetëm njeri nga shumë librat e profesorit të nderuar, të botuar ndër vite, për të cilat nuk isha në dijeni.

Duke lexuar librin, e para që më shkoi ndërmend ishte ideja se mbase edhe ndonjë nga psikiatrit e Kosovës do të mund të bënte një të tillë, për historinë e Psikiatrisë së Kosovës, nëse një e tille ende nuk ekziston!

Ishte mbresëlënëse sistemimi i periudhave të zhvillimit të Psikiatrisë shqiptare, organizimi i të dhënave, qasja kritike dhe analiza e sinteza e shënimeve dhe dorëshkrimeve të shumta, si dhe vështrimi polivalent i historikut. Një ndarje shumë e saktë e fazave të zhvillimit, e definuar me korrektësi, që determinonte horizontin e zhvillimit në kohë dhe cilësi. Një analizë e hollë, shumë e sistemuar dhe programuar, tepër përmbajtjesore dhe me mesazh të qartë. Shpjegimi i vetë zhvillimit të psikiatrisë në etapa është kaq i qartë dhe përmbajtjesor e aq i thellë, saqë lexuesi në çdo faqe të librit ndjen evoluimin e këtij zhvillimi. Më pas është impresionues theksimi i autoriteteve kryesore të Psikiatrisë shqiptare, vlerësimi i rolit të tyre dhe kontributit kyç në zhvillimin e saj, analiza e thellë e punimeve të tyre dhe evoluimi i zhvillimit shkencor si rezultat i këtij kontributi.

Ishte bërë një punë e jashtëzakonshme në grumbullimin e të dhënave dhe analizën e vërtetësisë së tyre, hartimit të kriterëve për përfshirjen e tyre në këtë historik



të psikiatrisë, të problemeve e strukturave të ndryshme në të gjithë vendin, si dhe te personaliteteve e individëve të veçantë që kishin lënë gjurmë të rëndësishme në zhvillimin e saj. Punë e jashtëzakonshme dhe me saktësi e vlerë të lartë. Veçanërisht është me vlerë qëndrimi personal e kritik i autorit ndaj veprimtarive dhe ngjarjeve të rëndësishme, të cilat sillen në libër në formë ditari, sigurimi i informacionit nga një numër i madh autorësh si dhe i konsultimeve të shumta me mjekë psikiatër që kanë jetuar vetë ngjarjet dhe kanë bashkëpunuar me personalitetet më të rëndësishme të psikiatrisë së Shqipërisë.

Libri përmban sqarime të detajuara të ecurisë së historikut të zhvillimit të psikiatrisë duke inkorporuar shumë punime shkencore, profesionale, botime të teksteve të specialistëve, shumë konsulenca, simpoziume, informacion për shoqatat e krijuara, evoluimin e terapive të zbatuara në hap me kohën, trajtimin polivalent të pacientëve, avancimet shkencore të personelit dhe publikimet përkatëse.

Nga gjithë kjo thellësi e qasjes analitike informacioneve, ngjarjeve, figurave të rëndësishme në ecjen e psikiatrisë shqiptare natyrshëm vjen ideja e autorit dhe sugjerimi i tij për ngritjen e një strukture administrative kombëtare, e cila do të merrej me koordinimin dhe menaxhimin e të gjithë problematikës që lidhet me zhvillimin programor të të gjitha shërbimeve psikiatrike në vend.

Duke lexuar me kujdes këtë libër dhe duke parë respektin e jashtëzakonshëm që shprehet nga AUTORI për psikiatrin, ndër më të mëdhenjtë që ka pasur Shqipëria, Prof. Dr. ULVI VEHBIU, më shkoi ndërmend se mbase do të duhej që Shoqata, "Lidhja e Psikiatërve Shqiptarë", LPSH, që shtrihet në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, të mbante emrin e këtij psikiatri shumë

të dëgjuar.


Kaq për librin!

Ndërsa unë e them me sinqeritet të plotë se, edhe pse në libër pashë figura të shquara të Psikiatrisë shqiptare, as i famshmi Prof. Ulvi Vehbiu, as e nderuara Dr. Tefta Pikuli dhe as psikiatrit në fotot e vendosur në fund të librit, asnjë prej tyre, as individualisht e së bashku, mua nuk do të mund të më ndihmonin ashtu siç më ka ndihmuar autori i këtij libri, Prof. Dr. VUKSAN KOLA. Jam e bindur për këtë, sepse tek ai janë të kombinuara, të ndërthurura në mënyrë simfonike, niveli i larte profesional, shkencor dhe intelektual si te asnjë tjetër. Veç tyre etika, qëndrimi ndaj pacientit, leximi i shkëlqyer i personalitetit të tij, sjellja e duhur, fjalët e pakta, të prera dhe të vendosura, personaliteti i tij që imponon, besimi që ai ngjall te pacienti, me një fjalë, një ndërthurje komplete e të gjithë cilësive dhe virtyteve me te larta të një psikiatri model! Dhe sigurisht, cilësitë dhe virtytet e veçanta të tij, bashkë me trajtimin e duhur terapeutik janë ato që sigurojnë suksesin.

Faleminderit i nderuar Prof. Dr. VUKSAN KOLA!

Jeni psikiatri emblemantik, ikona e Psikiatrisë Shqiptare, andej e këndeje kufirit, Njëshi i Psikiatrisë Shqiptare, një erudit i vërtetë e figurë poliedrike, që të mahnit me nivelin kulminat intelektual, shkencor, profesional dhe pedagogjik, psikiatri - them unë - me cilësi, nivel dhe përmasa ndërkombëtare!

Prishtinë, 16.3.2026



Disa këndvështrime për Poetin Frederik Rreshpja, Mjeshtër i Madh!

*Pjesëmarrës në tryezën shkencore kushtuar Frederik Rreshpes, në përvjetorin e 20-të të ndarjes nga jeta (3 mars 2026, Ora: 10.00, Salla «Akademikët»
(Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhës dhe i Letërsisë, Departamenti i Studimeve Letrare).*

Referimi, me temë: "DISA KËNDVËSHTRIME PËR POETIN FREDERIK RRESHPJA",
nga shkrimtari XHAHID BUSHATI

Të nderuar studiues, krijues, pedagogë e miq të pranishëm,

Gjatë leximit, rileximit dhe studimit të krijimtarisë së poetit Frederik Rreshpja në vite dhe në kohë, edhe sot ruaj të njëjtin mendim se, Rreshpja është një figurë, ende, e pa ndriçuar e kontradiktore në rrafshin studimor e social. Ndaj, unë, përzemërsisht falënderoj organizatorët e kësaj veprimtarie shkencore, në veçanti për prof. Ewaldën, për ftesën e bërë; që janë kujtuar për këtë figurë të nderuar, veçanërisht poetike, që la një krijimtari të pasur, si në poezi, roman, dramë, ese dhe mendime filozofike, letërsi për fëmijë... e të tjera. Sigurisht, dialogu, mendimi dhe kuvendimi në këtë veprimtari dobiprurëse do të ndriçojë më tej figurën e Rreshpes, që është e domosdoshme, e, njëkohësisht do të zbojë edhe shfaqjen e ndonjë hije të padëshiruar e keqdashëse në studimin dhe analizën e Fredit, këtij poeti të vërtetë, dhe të krijimtarisë së tij të pasur artistike, që la gjurmë në letërsinë shqipe.

E kam njohur Fredin.

Për shumë e shumë vite kam qenë mik i asaj shtëpie. Në këtë miqësi që e ruaj të shtrënjtë e të shenjtë; edhe atëherë edhe sot, e kam të ngulitur në mendje se Fredi me talentin e tij fali një kohë poeti, paksa të rrallë për një krijues të vërtetë.

Fredi nga natyra ka qenë i heshtur dhe lakonik në të folur. Bashkëbisedimet dhe shkrimet problemore vërtetojnë më së miri këto cilësi të tij. Edhe në këto hapësira, poezia, kjo bashkudhëtare besnike e tij, është gjithherë e pranishme.

Fredit asnjëherë nuk i ka munguar ngjyra poetike e shpirtit. Kështu në një shkrim që përcillet me një simbolikë trishtuese "Mesjetë kulturore", Fredi nënvizon raportet mes dritës së dijes dhe errësirës. Poeti shkruan: "Ne, njerëzit, e kemi pranuar me kohë që librat janë dritaret e shpirtit, pra e kemi pranuar me kohë që jetojmë në një lloj errësire që vjen nga mungesa e librave. Fatkeqësisht sot, sikur po ambientohemi me këtë errësirë..." (Rreshpja, Frederik "Mesjeta kulturore", gazeta "Drita", 07.06.1992). Vërtetësia e këtyre fjalëve në disa zhvillime e botime të letërsisë shqipe, ka gjetur mishërim.

Problemi i dytë që trajton Fredi, është ai i vlerave të librave dhe i kontributeve të shkrimtarëve që janë kthyer në modele të pavdekshme. Teksti mbart në nëntekstin e tij një lloj trishtimi, por njëkohësisht edhe një lloj shprese. Fredi, përsëri, shkruan:

"Shkrimtarë pa libra nuk ka. Njëpër tërë shekujt ne na kanë munguar shumë gjëra, por kemi pasur Bogdanin, Seremben, Mjedën dhe dhjetëra të tjerë. Kjo është një lloj mesjete që do të na kushtojë shumë. Kam parasysh të rinjtë. Kur një popull nuk lind shkrimtarë është më tepër se fatkeq. E para herë në histori që një popull pret të bëhet i lumtur, pa të shkruajë libra. Gjithmonë librat janë shkruar për t'i prirë lumturisë." (i njëjti shkrim, f. 6).

Të mbetemi tek thënia e Fredit: «Gjithmonë librat janë shkruar për t'i prirë lumturisë!» E përsërita këtë urtësi, për të vënë theksin mbi dimensionin e librit, universin e vlerave të tij në kohë e hapësirë.

Mbetet interesante në jetën e Fredit marrëdhënia e tij me rrugicën e fëmijësisë. Ajo rrugicë ka fiksuar në kujtesë

ecjen e shpejtë e pa zhurmë, shpesh vetmitare të Fredit. Ajo ecje, si një gjurmë poetike, mbarte në vetvete kontrastin mes njohjes dhe mosnjohjes së këtij njeriu me shtat të vogël e të mençur, nga banorët e kësaj rrugice. Mbarte edhe indiferencën e tyre për komshiun e heshtur. Nuk e di pse kujtova psikologjinë e mentalitetin e amullt, të mbylljes në vetvete e të asaj 'matanë murit', të shumë personazheve të trishtuar e ekzistencialë, të tregimeve realiste dhe moderne të Ernest Koliqit, për Shkodrën dhe mjedisin e saj, me gjithë nënshtresat sociale që i njohu aq mirë.

Bota e Frederikut nuk përkonte me "botën" e lagjes ku banonte. Planeti i tij poetik, edhe pse shpesh i përjash-tuar, tharmin, thelbin e tij e kishte "në këtë rrugicë...", ku Fredi me përlësi dhe nderim kishte vënë shpirtin e vet si një gur qëndresë, lavdie e jetese e më vonë si muranë. Kishte vënë lirikën si dëshmi, tregimet, legjendat dhe përrallat si ëndrra magjiplote. Ai me talentin dhe per-



sonalitetin e tij të spikatur po i shtonte gjurmët e vlerata rrugicës së tij të dashur e më gjerë, ku...

*«Çeli trëndafil i kuq te porta një mëngjes
Si vetëtimë.*

*Kështu erdhi dikur një vajzë me shall të kuq
E trokiti te porta.*

*Tani nuk jam më i ri dhe ngjyrat i ngatërroj
Ndoshta ky është një trëndafil i bardhë
Ndoshta ky është një trëndafil blu.*

*Megjithatë e di, erdhi një trëndafil me shall
Dhe, një vajzë çeli gjethe te porta.»*

Pikërisht në këtë rrugicë shëtiti, u mbrujt dhe lulëzoi fëmijëria e më pas personaliteti i Frederikut. Ishte një fëmijëri e vështirë, por me një përkujdesje të ëmbël mëmësie. Një mëmësi që fëmijërinë e ngrohu, edhe kur motet ishin të vranta e me shi, edhe kur motet ishin me diell të shndritshëm e nganjëherë përflakës. E folura si prej ninulle epike e legjendare e nënë Drandes ia ofronte të birit dhe ia bënte fëmijërinë e tij si magji e ngjyra për-ralle, të cilat do të linin gjurmë në poetikën e tij dhe në përrallat që i rrëfente magjishëm Fredi.

Ishte një fëmijëri brenda mureve të gurta të asaj rru-gice, ku lulëzonin e gjallonin edhe trëndafilat e kopshtit të Fredit. Dhe, vetë fëmijëria kthehej herë pas here në një trëndafil dëshirash e këngësh, shpesh edhe të pakëndueme. Në ato "të pakëndueme" vinte si mik Migjeni i talentuar, i papërsëritshëm e ndërplanetar.

Ishte ajo rrugicë dhe fëmijëria, që do të linin gjurmë të pashlyeshme në kujtesën dhe shpirtin e tij, të cilat do të

përbënin më pas kodet e poezisë së Fredit. Ishte fëmijëria në atë rrugicë me një botë plot ëndrra, ku edhe "ngjyrat ishin shpirt-tri" - siç shprehej Fredi, për të cilat poeti trishtohej e qante, vetmohej e mallohej, se ishte fëmijëri e "vizatuar" përmes ngjyrave të trëndafilave, të pëllumbit, të lotit të në-nës e të harresës, dhe nganjëherë e mall-kimit. Në kontekstin poetik simbolika e trëndafilat lë "shenjën" më të thellë, më të spikatur, aq sa bëhet "personazh-shpirti" i poezisë së tij. Kthehet në të shumtën e herës edhe në simbol. Në këtë kontekst, shpesh humbet përftesa e elementit zbukurues, joshës, aromëshpërndarës si kuptim i parë, i dytë, apo i tretë nga pikëpamja etimologjike. Kthehet në figurë me mëvetësi rreshpjane që mbart emocion e të fshehtë e poetit. Ngadalë-ngadalë kjo figurë vjen e shkrihet dhe bëhet pjesë organike me vargjet e poezisë. Ndërsa, vetë poezia fiton rrjedha të tjera (edhe melodike, edhe stilistike), e të tjera ngjyime e thellësi poetike. Nga i gjithë cikli me poezi, "rrenjën" e ruan ajo me titull "Trëndafilat e fëmijërisë." Veç shpirtëzimit të fëmijërisë së autorit, marrëdhënia e jetesa e tyre bëhet e mundur e theksohet në sajë të lidhjes së ngushtë me mitiken. Ato sjellin një imazh bibliq, një modelim përrallor, të cilin e gjejmë të jetueshëm më parë në krijimet dhe në kujtesën popullore. Por autori shkon më tej. E shenjtëron, duke pohuar: "Në fund të kopshtit banonte mitologjia / në një Olimp prej trëndafilash /..." Kjo figurë gjatë gjithë ciklit është e pranishme në dy pamje të ekzistencës së saj:

a) në përdorimin e njëjësit për shumësin për t'i dhënë më shumë frymëmarrje, dhe b) në përdorimin e shumësit për njëjës për t'i dhënë konkretësi. Si në rastin e parë, ashtu edhe në rastin e dytë, raportet e konkretes me abstrakten sjellin dhe ruajnë imazhe e përfytyrime ireale. Spektri i krahasimeve, me objekt të vetëm dhe në qendër trëndafilin, (që nga psherëtimat, e deri te drurët e vdekur) nuk është gjë tjetër veçse vibration e gjendjes shpirtërore të Fredit. "Poezia e Frederikut shpjegohet si vetëdije e shpirtit të fëmijësisë dhe pasioneve të saj, sepse përcaktimi thelbësor që i bëhet kësaj poezie është: ligjërimi i imazheve të kësaj fëmijërie. Poezia vjen

nga bashkëshoqërimi i ideve dhe ngjyimeve që nxisin fjalët përmes kujtimeve, emocioneve dhe dëshirave. Për t'u shprehur, poeti përdor sendet që e rrethojnë, imazhet e ëndrrave dhe objektet e ëndrrave të veta. Faktorë të organizimit ritmik janë zgjedhja e fjalëve, rendi i veçantë i tyre, vargjet e mirëkontrolluara." (interpretim i poetit Gazmend Grasnqi për 100 lirikat e Fredit, pjesa: Poezia që ndiente dhe ëndërronte...).

Në finale, Fredi pasi ka mbartur gjatë gjithë «udhës» përjetimet e tij poetike, nuk ka bërë gjë tjetër veçse ka përvijuar dukshëm elementet e profilit të tij. E padukshmja në profilin e tij poetik zbulohet gjatë aktit të rileximeve të poezive të poetit. Sigurisht, njohja do të jetë edhe më e madhe, dhe, ashtu, siç thotë shkrimtari Petrit Palushi: «... do ta njohim Frederikun, (për) atë që s'e kuptuam kurrë.»

Përsa i përket komunikimit artistik e poetik këto gjendje emocionale, këto akuarele nga bota floreale i gjejmë me një bukuri të pashoqe të shprehura në faqe të tëra të romanit «Zëri i largët i kasolles» e në paragrafët e shumë përrallave që Fredi i rrëfente aq ëmbël që përherë të kujtonin Andersenin.

Romani «Zëri i Largët i kasolles» që i dallueshëm në letërsinë tonë shqipe për tiparet e një proze poetike. Për romanin në fjalë, kritika letrare pati shumë ngurrime dhe nuk ishte aspak entuziaste në gjykimet e saj. Analiza e saj u përqendrua më shumë rreth interpretimit të fabulës dhe mënyrës se si janë portretizuar personazhet. U harruan edhe disa dukuri të tjera, të rëndësishme, si këto në mendimin tonë: mjedisi i dhënë me vërtetësi, koloriti i ngjyrave, bota, psikologjia, mentaliteti, jeta dhe ëndrra e personazheve që lëviznin, frymonin gjallërisht në roman.

Po i kthehem, përsëri poezisë. Nuk gaboj po të them se poezia e Fredit lulëzoi së pari tek ai gjelbërim spontan që shfaqej në oborrin e tij, gjelbërim që i ngjante një mrekullie të pashoqe. I ngjante një, një pikturë surreale, vevanërisht kur hëna vinte netëve si mike, si përrallë e pastaj hidhte rrezet e saj lodërtare. Të mos harrojmë se kjo mrekulli kishte «çelur» më parë në shpirtin e Fredit. Ruhej besnikërisht, po e tillë shfaqej në lirizmin e poezisë së tij. Lulëzoi edhe tek ato trëndafila, që u bënë metafora ëndrrash e dhimbjesh, heshtjesh e pikëllimesh. Çelën, lulëzuan e kurrë s'u thanë në vetminë poetike të Fredit. Mori jetë talenti i tij. Jo më kot studiuesi Isak Es-hrefi, na thotë: «Në pjesën dërmuese të vargjeve të lirikave të Frederik Rreshpes, jepet një dramë e brendshme përvëluese. Lirizmi i këtij poeti rrëshqet prore brigjeve të revoltës. Poezia e tij është përplot shqetësime, shqetësime të mëdha që buronin nga përditëshmëria e jetës së tij. Vargjet e lirikave të Rreshpes botën e tij personale, me ngarkesa shqetësuese shpirtërore. Duke gjurmuar fine-sat e artit të Rreshpes, pahetueshëm rrëshqasin në të të dhënat e tij jetëshkrimore, që përbëjnë këpujën lidhëse: krijuesi-vepra e tij.»

Dua të ndalem, dhe te disa vështrime mbi shpirtin poetik të Fredit. Në krijimet e viteve të fundit të vështrura në konceptin filozofik e poetik të krijuesit Frederik Rreshpes, metafora e Vetmisë u bë domethënëse dhe e dukshme, gjalluese, ripërtëritëse, duke u bërë lajtmotiv i krijimtarisë së tij, siç ishte edhe lajtmotiv i jetës së Fredit. Shpërfaqja e tij u duk në vëllimin «Në vetmi», vëllim që i ngjan një testamenti lamtumire.

Metafora e VETMISË gjen mbështetje në dy rrafshe: a) në lirikën surreale, e cila përbën tiparin themelor të krijimtarisë së tij. b) në spontaitetin, që përbën një nga veçoritë e personalitetit poetik dhe krijimtarisë së tij me theks e prirje, veçanërisht drejt lirikës moderne.

Anatomia e poezisë së Rreshpes është e lidhur me jetën e tij. Një simbiozë në dukje e çuditshme, por e vërtetë. Aty duhet t'i kërkojmë fillesat dhe bulëzimet poetike për të qenë më të qartë për rrugën e tij krijuese që, nga libri në libër sillte befasi e imazhe të reja, dukuri e vlera. Njëkohësisht, për të kuptuar përse Metafora e VETMISË dhe mistikja, si elemente të krijimtarisë poetike shëtisin aq lirshëm në hapësirat poetike, duhet t'i kërkojmë po aty, te jeta vetjake e poetit. Aty gjejmë gëlimin e simboleve të fëmijërisë, të dhimbjes, të fatit, të trishtimit dhe të vdekjes. Poeti dhe studiuesi Tonin Kaçaj duke iu referuar njërit prej simboleve, atij të trishtimit, rrëfen, kështu: «Në

heshtje, pa zhurmë, me tingullin e një gjethi që bie në pejzazhin e brymtë të vjeshtës së vonë e, ku gjithherë yjet nuk mungojnë, poeti Frederik Rreshpja do të shkruajë: «Kur të mbyllen sytë e mi, nuk do të ketë më det / Për varkat e lotëve / ... Unë kam qenë trishtimi i botës.» Ç'të jetë kjo, thjesht një metaforë e pashoqe për kah bukuria dhe dhimbja, e tejpashme si trupi i dritës ku tashma dhe loti i vdekur i poetit ndihet i takuar me dritën në atë çastin e amshimit, e ku shpirti ndihet i zgjidhur prej trupit, apo e gjithë shënjon rrugëtimin e sapo nisur të poetit, edhe pse rrugë s'ka askund, sepse rruga sëkziston e ku gjithherë drita rri e fshehur mbas një skute terri?.. Apo ndoshta ky përbën një kumt, një shpallje-psherëtimë të poetit për Botën, se ai kishte qenë trishtimi i saj...»

Ato vite me Fredin jetojnë brenda meje. Janë vite, kur unë jam ulur te ajo sofa e drunjte dhe kam ngrënë bukë nga duart e nënë Drandes. Ishte nëna e Fredit. Një grua fisnike. Çdo gjë fisnike ishte qëndisur tek ajo grua malësore!

E kam parasysh si tani atë grua të pashme, të gjallë, shumë e shoqërueshme dhe mirëbërëse. Ajo kishte lindur për të qenë e tillë. Vështrimi i saj, Fredit gjithherë i sillte një paqe hyjnore. Kurse vështrimi i Fredit ishte një kurorë nderimi për nënë Dranden.

Di (dhe e pashë me sytë e mi), që ajo qepte bukur e plot art rrobat kombëtare, posaçërisht ato të trevës së Shkrelit, ku kishte lindur. Ishte mjeshtre e vërtetë. Mjeshtër i vërtetë ishte edhe Fredi në këtë zeje, që ia trashëgoi e ëma. Mjeshtër, në qepjen e xhamadanëve. Shihet dukshëm që lidhja nënë-bir ishte shumë e fortë. I lidhte fryma e një dashurie. Prandaj poeti Rreshpja i kushtoi figurës së nënës, dy poezi, «Vendlindja e nënës» dhe «Elegji për nënën.» Të para në këndvështrime të ndryshme, ato fokusohen në një pikë të përbashkët, në dhënien e dimensionit artistik të portretit të njeriut më të shtrenjtë, më të paharrueshëm e më të dhembshur për Fredin. Poezitë nuk mund të kuptohen pa njëra-tjetrën, janë plotësim i njëra-tjetrës, përparësisht në dhënien e detajeve për të plotësuar «biografinë» dhe cilësitë e saj. Në komunikimin artistik, prania e poetit ndjehet dukshëm dhe ngjan sikur bisedon me Nënë, bisedë që vazhdon gjatë...

Në poezinë e parë figura e nënës është shkrirë me vendlindjen, ku si arketipe të poetit gjejmë fjalët kyçe: shkallë drite, greminë, druri i lahutës, pasqyrime krojesh, ... etj., përmes të cilave njëjtëson adhurimin dhe përjetësimin e figurës së Nënës dhe Vendlindjes, siç thamë të shkruara në një, në sinonime të njëra-tjetrës, në njëjtësim. Poezia, krahas përjetimit lirik, ruan si dekor edhe ca tise të lehta tragjizmi, përzier me fllade dashurie.

Në poezinë e dytë pikëllimi i poetit pikëllon mbi elegjinë që ka thurur me dhimbje. Një pikëllim që përlligj pikëllimin e poetit. Momenti tragjik të ikjes së nënës së tij të shtrenjtë, Fredi e shpreh: «Ishte një botë e tërë kur ishe ti / por erdhi kjo vetmi e madhe që fshin gjithçka.»

Poezia, ndonëse ruan tiparet e elegjisë, në mënyrën e ndërtimit të saj strukturor, me përdorimin e anaforsë e të apostrofit përmes kadencave e ritmeve, na bën të ndiejmë e të pohojmë se ajo është parë dhe konceptuar, duke u bazuar mbi shfaqjen dhe natyrën tradicionale të vajtojcave të Veriut. Ky rit në këtë poezi mbart vlerën e mitit. Miti në vetvete këndvështrohet në tre aspekte: - në atë të trishtimit, - të madhështisë, - dhe të përjetësimit.

Duke parë lëndën poetike të Frederikut, studiuesi Sadedin Mezuraj bën një pohim të tillë: «Poezitë e Rreshpes kanë një frymë thellësisht humane, lirizmi i tij mbart nota epike, motivet e dashurisë mbështillen me tisin e trishtimit, pikëllimi ka frymën e baladave ballkanike.»

«tani erdhi ora të vdes përsëri...» - thotë në një poezi Fredi. Iku nga kjo botë, në heshtje dhe i vetmuar, liriku më i shquar i letrave shqipe, Mjeshtri i lirikës moderne, së cilës i dha zërin e vet të magjishëm e fluror, tronditës e të pikëlluar.

Poeti Shpëtim Kelmendi thotë për poetin Frederik Rreshpja: «Shumë njerëz nuk e dinë në është gjallë, disa të tjerë shfryjnë se ai e meriton fatin që ka, po për një gjë të tillë janë të detyruar të bien dakord: që ai është një nga poetët më të mëdhenj të poezisë shqipe. Fredi po shman-

get pak e nga pak, ashtu si dielli që prihet kah perëndimi pa i interesuar nëse ndokush asht i kënaqun apo mirënjohës për ngrohtësinë e tij. Po perëndon. Dalëngadalë po hyn në legjendë. Pa zhurmë, pa tërsëllimë, pa bujë, pa lavde. Thjesht po shkon në periferi të vëmendjes sonë të ngarkuar me gjëra të rëndësishme, ashtu siç shkoi De Rada, Serembe, Mjedja, Lasgushi, Asllani. Nesër do ta kujtojmë me respekt. Do t'ia festojmë praninë e tij të dikurshme midis nesh. Nesër do të shfaqet e do zhduket lirish nëpër kujtesat tona. Nesër...»

Statusi i lirikës së Fredit lidhet me përjetimin tragjik të fatit të tij. Është një përjetim solid, bashkëveprues dhe i ndërsjelltë për të vazhduar, përsëri më tej nga stilemat drithëruese të përfytyrimi, dhe më tej, nga raporti i ngjyrave të ndërtimi i arketipeve.

Peizazhi i endur në vargjet e tij, për nga mënyra e ndërtimit arkitekturor ruan frymën dhe parafytyrimin poetik të Fredit, për të cilat ka sigurinë e plotë. Në poezinë e tij çdo fjalë është e shenjtë, se di t'i shenjtëroj fjalët! Ato fjalë që kthehen në figura të krijuara nga «uni» i poetit Frederik Rreshpja, janë tiparet, mjetet e shprehjes, emocioni dhe shpirti i tij. Janë përcaktuesit e individualitetit të lirikut Rreshpja.

Metafora e «Hënës...» shëtit kudo në hapësirat e poezisë së Frederikut. Ajo është më shumë se një bashkudhëtare, është bashkëjetesë në fatin e poetit. Mënyra e perceptimit, shfaqja e saj, copëzat që zë, pesha që mbart si ngarkesë emocionale, «shenja» që lë si element i kudo-pranishëm, sa në rrafshin horizontal, aq edhe në atë vertikal të krijimit, i bën dritë jo vetëm poezisë, por edhe vetë poetit. Ashtu siç shprehet ai: «dhe hëna projekton profilin tim në xham. / Kështu do të iki, vizatuar nga hëna.»

E me hënë poeti bisedoi gjatë, shumë gjatë... Në shumë biseda poetike me poetin, ajo nuk donte të perëndonte...

Po sjell në vëmendje disa nga ato biseda të poetit me hënë për t'u magjepsur me drithërimat e shpirtit të tij.

- Hëna si dëshmitare e ngjarjes.

- Hëna në ornamentikën e peizazhit.

- Hëna si element tipizues i personazhit.

- Hëna - si: dhimbje, adhurim, mall, shpresë, trishtim dhe kujtim...

- Hëna si element përrallor e mitologjik.

- Hëna si element tragjik.

E në këtë pemë gjenealogjike «të përpiluar» me mjeshtri nga autori Frederik Rreshpja, ku në trung të saj ka Metaforën e Hënës, është e pamundur të mos vëshre hyjnizimin e hënës si hyjni e natyrës, besimin tek ajo, së cilës i falet, e adhuron, i lutet përmes «formulave sa poetike aq dhe magjike rreshpjane.» E «Hëna» shfaqet herë si kult e herë si simbolikë përmes përjetimeve të poetit, por duke ruajtur si gjithnjë universin e saj. Po universi i Fredit, ku është?.. Mbase te poezia «Fat», mbase te poezia «Kur vdesin hënëzat», mbase tek...? Ndoshta edhe te këto vargje: «Mirëpo, unë jam pagan i vjetër; / Pa këtë fat të keq nuk ndihem mirë, / çdo njeri e ka një fjalë ku vë kryet / kam edhe unë për prehe dhimbjen time.» Ky ishte Universi i Fredit dhe Universi i Hënës, sigurisht i Fredit dhe i Hënës së bashku...

«Bie një gjethe tërë vjeshtë

A një dridhje muzgu.

Bie alarmi i shirave, rrëzohen udhët e zogjve

Dhe hëna projekton profilin tim në xham.

Kështu do të iki, vizatuar nga hëna.

Do desha të shkoja në hënë

Për të kujtuar pikëllimet e rinisë.

Nga larg me mall do vështroj tokën,

Shtëpinë ku u deshëm dhe u grindëm përjetësisht.

Por, zemra ime, hënë nuk ekziston

Që ditën që u shfaqte ti.»

Ju faleminderit!

XHAHID BUSHATI
Shkodër, 17 shkurt 2026

Ndrek Luca - Mjeshtri i Skenës dhe Ekranit Shqiptar



GJON MARKU

Artisti shqiptar Ndrek Luca (1927–1993) përfaqëson një nga figurat më të shquara dhe më të rëndësishme dhe më përfaqësuese të teatrit dhe kinemasë shqiptare të shekullit XX. Karriera e tij, e pasur me role të ndryshme teatrale dhe filmike, pasqyron jo vetëm aftësitë individuale të interpretimit, por edhe kontekstin historik dhe shoqëror të kohës. Ai nuk ishte thjesht një aktor me talent të veçantë interpretimi, por një personalitet artistik që ndikoi në mënyrë të dukshme në zhvillimin dhe konsolidimin e traditës teatrale dhe kinematografike shqiptare. Përmes një karriere të gjatë dhe të pasur me role të shumta në teatër dhe film, si dhe përmes angazhimit të tij në dramaturgjinë kombëtare.

Ndrek Luca arriti të krijojë një profil artistik të qëndrueshëm dhe me vlera të larta estetike e kulturore.

Ndrek Luca lindi më 3 shtator 1927 në fshatin Khan të krahinës së Pultit, të Dukagjinit, pranë Shkodrës, një zonë e

njohur për traditat e forta kulturore dhe artistike. Familja e tij ndikoi në formimin e tij moral dhe estetik, duke i dhënë një bazë të fortë kulturore. Që në moshë të re, Ndrek Luca tregoi interes për artin dramatik, megjithëse fillimisht ndoqi studimet në Akademinë e Aviacionit në Beograd. Për shkak të tensioneve politike midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, ai u detyrua të kthehej në vendlindje dhe iu përkushtua karrierës teatrale.

Në vitin 1950, ai iu bashkua trupës së Teatrit Popullor (sot Teatri Kombëtar) si aktor profesionist, duke filluar një karrierë që do të shënonte një epokë në artin dramatik shqiptar. Bashkëshortja e tij, Mimika Luca, gjithashtu aktore, ishte partnerja e tij në jetën personale dhe profesionale, duke krijuar një çift që kontribuoi në zhvillimin e teatrit shqiptar.

Gjatë karrierës së tij, Ndrek Luca interpretoi më shumë se 100 role teatrale, duke përfshirë drama klasike dhe komedi, si dhe krijime origjinale shqiptare. Ai interpretoi figura të thella dhe komplekse, duke u dalluar për:

- **Rolin tragjik** – interpretime të personazheve me dilema morale dhe konflikte të thella emocionale.

- **Rolin komik** – aftësia për të balancuar humorin subtil me realitetin shoqëror.

- **Rolin dramatik realist** – portretizimi i figurave të përditshme me një dimension psikologjik të pasur.

Ai punoi me dramaturgë shqiptarë dhe të huaj, duke përfshirë Shekspirin, Brechtin dhe autorë shqiptarë të shekullit XX. Disa nga rolet më të shquara përfshijnë:

- **Iago** në "Otello" (Shekspir) – një interpretim i thellë dhe psikologjik, që evidenton konfliktin e brendshëm të personazhit.

- **Xhiri** në "Arturo Ui" (Brecht) – një

kombinim i realizmit dhe satirës politike.

- **Shpend Gjeto Plaku** – një figurë shqiptare me dimensione sociale dhe morale të ndërlikuara.

- **Dom Pali** – personazh kompleks që tregon tensionin midis autoritetit dhe emocioneve humane.

Ndrek Luca ishte edhe autor i disa dramave shqiptare, përfshirë:

- **Shtatë Shaljanët**

- **Votra e huaj**

- **Andrra në diell**

Këto vepra pasurojnë repertorin shqiptar dhe tregojnë përkushtimin e tij ndaj dramaturgjisë dhe artit të shfaqjes skenike.

Përveç teatrit, Ndrek Luca la gjurmë të thella në kinematografinë shqiptare. Ai interpretoi role të ndryshme që varionin nga figura historike dhe role sociale, deri te karaktere të zakonshme qytetare. Ndrek Luca interpretoi mbi 30 role filmike, duke përfshirë filma historikë, drama sociale dhe komedi. Disa nga rolet më të njohura janë:

- **Komisari i Dritës** – një figurë morale dhe e ndërlikuar, e vendosur në një kontekst shoqëror.

- **Plagë të Vjetra** – interpretim dramatik që pasqyron traumat dhe konfliktet e personazheve.

- **Operacioni Zjarri** – një kombinim i komedisë dhe tensionit dramatik.

Roli i tij në film ka kontribuar në zhvillimin e kinematografisë shqiptare dhe ka reflektuar realitetin e kohës me thellësi psikologjike dhe shoqërore. Këto tipare i dhanë Ndrek Lucës aftësinë për të krijuar një lidhje të veçantë me audiencën, duke bërë që çdo interpretim i tij të ishte i paharrueshëm.

Ndrek Luca ishte i njohur për një stil unik interpretimi. Kontributi i tij është i

madh dhe i shumëdimensionuar:

- **Realizmi emocional** – ai përdorte intonacionin, mimikën dhe gjestet për të krijuar emocione të besueshme.

- **Ndërtimi i personazheve** – çdo rol ishte i analizuar dhe i zhvilluar me dimensione psikologjike të plota.

- **Adaptimi ndaj regjive të ndryshme dramatike** – ai ishte i aftë të interpretonte nga komedia te tragjedia, pa humbur autenticitetin e karakterit.

Këto elemente e bënë një aktor të paharrueshëm dhe një model për brezat e ardhshëm.

Ndrek Luca ndikoi në:

- standardet profesionale në teatrin dhe filmin shqiptar;

- formimin e identitetit kulturor dhe artistik të vendit;

- frymëzimin e aktorëve të rinj dhe studiuesve të artit dramatik.

Për punën e tij, ai u nderua me titullin "Artist i Popullit", një nga vlerësimet më të larta në Shqipëri.

Në kontekstin shqiptar të shekullit XX, Ndrek Luca mund të krahasohet me:

- **Aleksandër Moisiu** – për thellësinë e interpretimit;

- **Robert Ndrenika** – për aftësinë për të krijuar lidhje emocionale me publikun.

Megjithatë, ai dallonte për kombinimin unik të realizmit me teknikën dramatike moderne, duke e bërë një fenomen të veçantë në historinë e aktrimit shqiptar.

Studimi i Ndrek Lucës është i rëndësishëm për shkencën e artit dramatik, pasi ai përfaqëson një shembull të veçantë të ndërtimit të personazheve komplekse dhe të ndikimit të aktrimit në formimin e identitetit kulturor.

Ndrek Luca ishte një mjeshtrë i aktrimit që kontribuoi në zhvillimin e artit dramatik shqiptar. Ndrek Luca nuk ishte vetëm një aktor; ai ishte një fenomen i artit dramatik shqiptar. Karriera e tij, e pasur me role të paharrueshme në teatër dhe film, si dhe përkushtimi ndaj zhvillimit të dramaturgjisë shqiptare, e bëjnë atë një subjekt të rëndësishëm për studime shkencore dhe analiza kritike. Trashëgimia e tij vazhdon të frymëzojë aktorët e rinj dhe të mbetet një pikë reference për të gjithë studiuesit e artit dramatik dhe kinematografisë shqiptare.

Ai kontribuoi veçanërisht në:

- zhvillimin e dramaturgjisë dhe interpretimit teatror;

- pasurimin e kinemasë shqiptare;

- formimin e identitetit kulturor dhe artistik të vendit.

Trashëgimia e tij mbetet një pikë reference për studiuesit e artit dramatik dhe për aktorët e rinj, duke u bërë një shembull i përkushtimit dhe kreativitetit artistik.

Veprimtaria e tij artistike dëshmon për një nivel të lartë profesionalizmi dhe për një aftësi të rrallë në ndërtimin dhe interpretimin e per-



Mësuesit pensionist dukagjinas festojnë së bashku 7 Marsin!



Ka gati po aq që nuk jetojnë, por që kanë siguruar pavdekësinë, duke lënë veprën e kontributin e tyre në shërbim të shkollimit në Dukagjin e më gjerë.

7 Marsin e sivjetshëm e festuam në Bar-restorant "Alderi" në Dobraq, në një ambient shumë festiv. Morën pjesë rreth 30 pensionist nga të gjitha krahinat e Dukagjinit: Shllak, Toplanë, Shosh, Shalë e Pult. Më shumë munguan për arsye objektive, shëndetësore apo edhe indiferentizëm, duke mos u përpjekë me e kalua një ditë ndryshe.

Fillimisht pensionisti me moshë më të madhe nga të pranishmit, ju uroj të pranishmeve mirëseardhjen dhe gëzuar festën e 7 Marsit, duke ju shpreh dëshirën që të festojnë edhe shumë 7 marse të tjerë, me shëndet të plotë e zemër plot.

Mirëseardhje të veçantë për ata që për herë të parë ju bashkuan bashkësisë sonë, duke ju uruar që të kenë më shumë vite pensioni se vite pune si: Violeta Plepit, Nikë Gërmushës e Ndue Stragut.

Nga 7 marsi i kaluar na mungoj pensionisti më i vjetër Ndue Qerimi, i cili pak ditë më parë ndërroj jetë në moshën 88 vjeçare. U lutëm për Të, që të jetë mirë me Zotin, duke mbet i paharruar kujtimi i tij!

Nga të pranishmit gati gjysma ishin gra, të cilave ju uruam edhe 8 marsi Festen e Gruas, sepse nuk kanë qenë vetëm mësuese model, por janë edhe nëna e gjyshe shembullore.

Të gjithë pensionistët e shkollimit dukagjinas kanë kontribuar në zhvillimin e konsolidimin e shkollës në Dukagjin e më gjerë në të dy sistemet, në monizëm e në demokraci.

E gjithë dreka u zhvillua në një frymë shumë vëllazërore. Pjesa më e madhe e bisedave vërtiteshin rreth shkollimit dhe sot, duke mos vënë shenjën e barazimit midis tyre, por duke bërë një vlerësim shumë objektiv. Gati njëzëri deklarorin, se më lart shkollimi ka qenë në Monizëm, duke mos qenë nostalgjik, porse përkushtimi i mësuesve, prindërve e nxënësve ka qenë maksimal e kjo ka sjellë cilësi në edukimin dhe përvetësimin e dijeve shkencore nga nxënësit. Edhe kujdesi e kontrolli i shtetit ka qenë i lartë, për rrjedhojë autoriteti i mësuesit ishte i madh. Nuk jemi nostalgjik, se para nëntëdhjetës në Dukagjin ka pas 5 shkolla të mesme të bashkuara e shkolla të shkollimit bazë në çdo fshat; ndërsa sot nxënësit numërohen me pikatore nga shpopullimi, por përkushtimi për ta përmbush misionin fisnik të mësuesit, puna me shumë ndërgjegje, duke përballuar vështirësi nga më të ndryshme ishin në shkallën më të lartë e kjo reflektohej në rezultatet e larta në procesin mësimor- edukativ, ku nxënësit dukagjinas në çdo shkollë të mesme apo të lartë që shkonin jashtë Dukagjinit shkëlqenin.

Shkollimi ishte më cilësor në fshatrat

më të largëta të Dukagjinit dhe, se në mes të qytetit sot. Atëherë nxënësit përqendroheshin vetëm për t' u pajisë me dije, e sot nxënësit gjithçka bëjnë përveç mësimit, sepse e kanë mendjen te celulari, droga e pajisja me mjete prerëse.

Sigurisht që edhe sot ka përjashtime.

Pjesëmarrësit treguan episode të ndryshme nga jeta ndër shkolla, biseda më tepër për të qeshur, ku brenda kishin shkollën dhe sot, vlerësimet e vështirësitë. Pra, dominoi ora gazmore e vlerësimi për njëri – tjetrin.

Edhe pse kjo drekë vijoi disa orë na u duk se mbaroj shumë shpejt.

Shumë të këndshme këtë drekë e bëri edhe menyja shumë cilësore dhe e larmishme, si dhe shërbimi shumë i kulturuar, që lokali "Alderi", me pronar Marash Zefin, na ofroj duke përfshirë edhe çmime shumë konkurruese ku harmonizoheshin sasia me cilësinë.

Jemi shpresëplotë, që veprimtari të tilla do bëhen traditë jo vetëm për 7 mars, por edhe ngjarje të tjera, që na bashkojnë, me dëshirën që nga bashkësia e pensionistëve të shkollimit dukagjinas mos të shkëputet asnjë pjesëtar edhe shumë vite, por të shtohet me element të ri nga viti në vit.

Përgatiti
PRELË SHYTANI,
Mars 2026

Është i treti vit radhazi që mësuesit pensionist dukagjinas festojnë së bashku 7 marsin.

Edhe sivjet na gjeti së bashku 139 vjetori i shkollës së parë shqipe dhe mendojmë, që të bëhet traditë e përvitshme.

Dukagjini ka sot rreth 70 pensionist të arsimit që jetojnë, të cilët kanë dhënë një kontribut të vyer në masivizimin e zhvillimin e shkollimit në Dukagjin e më gjerë, duke u shkrirë si qiri për edukimin dhe pajisjen me dije shkencore të nxënësve dukagjinas, duke sakrifikuar e mposhtë çdo vështirësi për të realizuar detyrën e shenjtë të mësimdhënësit e edukatorit.



sonazheve me dimensione të thella psikologjike dhe shoqërore. Përmes interpretimit të figurave të ndryshme dramatike, ai arriti të pasqyrojë realitetin njerëzor dhe shoqëror të kohës, duke i dhënë aktrimit një dimension të gjerë artistik dhe reflektues. Në këtë mënyrë, Ndreka Luca u shndërrua në një nga përfaqësuesit më të spikatur të shkollës shqiptare të interpretimit skenik.

Në këtë kuptim, figura e Ndreka Lucës mbetet një pikë referimi e rëndësishme në historinë e teatrit dhe të kinematografisë shqiptare. Trashëgimia e tij artistike vazh-

don të ruajë vlerë jo vetëm si një dëshmi historike e një periudhe të rëndësishme të zhvillimit të artit skenik shqiptar, por edhe si një burim frymëzimi për brezat e rinj të aktorëve dhe për studiuesit e fushës së artit dramatik. Përkushtimi i tij ndaj profesionit, serioziteti në trajtimin e rolit dhe kreativiteti i tij interpretues e bëjnë Ndreka Lucën një model të rëndësishëm në traditën teatrore dhe kinematografike shqiptare.

Literatura e përdorur:

1. Topalli, T. (2020). Drama morale dhe

fati i individit në romanin "Kurvënata". Tiranë: Akademia e Studimeve Shqiptare.

2. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (2009). Fjalori Enciklopedik Shqiptar. Tiranë: Akademia e Shkencave.

3. Papagjoni, J. (2006). Historia e Teatrit Shqiptar. Tiranë: Onufri.

4. Papagjoni, J. (2014). Enciklopedia e Teatrit dhe e Kinematografisë Shqiptare. Tiranë: UET Press.

5. Zheji, A. (2003). Teatri dhe kinemaja shqiptare. Tiranë: Toena.

6. Qendro, R. (2004). Teatri shqiptar në shekullin XX. Tiranë: ShBLSH.

7. CNA.al. (2018). "Artisti i Popullit Ndreka Luca – Një nga aktorët më të dashur të publikut". Marrë më 10 mars 2026.

8. Shqiperia-etnike.com. (2020). "Ndreka Luca – i madh përballë sfidave të vështira skenike". Marrë më 10 mars 2026.

9. Top Albania Radio. (2023). "Art në zi: ndahet nga jeta aktoria Mimika Luca, bashkëshortja e Ndreka Lucës". Marrë më 10 mars 2026.

10. Arkivi i Filmit Shqiptar. (2022). Filmat artistikë shqiptarë dhe aktorët e tyre. Tiranë.

Libri “Shllaku n’shekuj”

Këto ditë pranverore të marsit 2026 erdhi në duart e lexuesve libri “Shllaku n’shekuj” në dy vëllime me autor Bep Martin Pjetri, ku u bashkëbisedue me kuvendarët shllakas dhe dashamirës të dielën e 8 marsit 2026. E shfletova me kujdes librin, ku përshkruhej Shllaku në të gjitha aspektet e saj si në aspektin arkeologjik që simbas arkeologve u përkisnin gjetje e vorret e eshtnave katallane, shtiza lufte dhe enë guzhine në trajtë poçerie të para 2600 vjeçare. Aty gjen një studim shkencor i ekipit gjuhësor të Universitetit të Shkodrës “Mbi të folmen specifike të Shllakut”. Për herë të parë asht përmend emni Shllak në 1640. Aty trajtohet me shumë seriozitet etno-kultura si në fushën e veshjes kombtare së femnave dhe burrave, ku femna shllakse kishte xhubletën të veçantë nga xhubletat e krahinave të veriut simbas ekspertve. Aspekti folklorik si Psiha e një kombit simbas At Gjergj Fishtës asht trajtue hollsisht duke prezantuar randsinë e saj dhe grupet artistike folklorike të Shllakut. Arsimi mbi 70 vjeçar, shkollat e mesme dhe fillore e 8 vjeçare ishin ambiente kuadrosh si agronom, veterinar, ekonomistë, dhe prej tyre i drejtohen auditoreve universitare.

Në libër janë trajtue hollsisht toponimi fshat për fshat nga burime të sakta të At Gjon Karmës, apo të kuptimit dhe funksionit të fjalës Shllak nga D. Nikoll Gazulli. Randsia e toponimeve konsiston te larmia e tyre që shpjegon rrathët koncentrik të historisë në epoka të ndryshme, mbi traditat, mbi mnyrën e jetesës, kulturën e tjera.

Historia e Shllakut zenë një hapsinë të konsiderueshme duke fillue nga periudha pellzge, ilire, arbneshe e deri në periudhën e sotme. Historia e Shllakut ka spikat heronjtë e saj që kanë lanë gjurmë drite dhe gjaku për liri, për nder, për mbrojtje te territorit, për mbrojtjen nga padrejtsitë e kohnave të ndryshme si: Gjekë Gega –

Gegaj në luftra kundër sllavit, ku i ka latue Ati i Kombit At Fishta në Veprën “Lahuta e Malcis” në 324 vargje.

Historia e Shllakut asht integruar me Dukagjinin, Drishtin, Dushmanin, Temalin, Toplanën, Komanin, Pukën, Shkodrën



në periudha kyçe të historisë si në rilindje, si në luftra kundër turqve, kundër sllavit, kundër komunistve. Por u trajtue epoka e komunizmit me të mirat dhe ekstremet e luftës së klasave ndaj disa banorve shllakas deri burgosje, tortura dhe pushketime, por e shkolloi, e elektrifikoi, e zhvilloi bujqsinë, blegtorin, hapi shkolla të

fillore, 8 vjeçare dhe të mesme, hapi konvikte, qendra shndetsore, spitale, kinema, biblioteka, vatra kulture e të tjera.

Gjetë Gegë Shllaku edhe Begolli; Vjen Çun Mula e vjen Mar Lula / Njani Hot e tjetri Shalë / T' fortë per pushkë e t' urtë

min e nji Akti Politik të Pavarsis së Shqypnis. Dhe ranë heroikisht sbashku me Gjon Nush Palin në luftë kundër pushtuesit osmane në Hot të Malësisë së Madhe. - Gjon Leka i Gegajvet të Shllakut (Kumbara që i shpëtoi jetën Mustafa Pashës), besnik deri në vdekje. Ishte Flamuri Kastrioti që kishte pështjell në parzem të krahanorit, shllaksi Hilë Mosi, rilindasi, burrë shteti i dhuruem burrave të Kojës në Ngritjen e Flamurit shqyphtar në Majën e Deçiqit, më 6 prill 1911, për herë të parë mbas 15 prillit 1479, që u ba frymzim i madh i burrave Luigj Gurakuqi, I. Qemali, I. Boletini e të tjerë. në ngritjen e Flamurit në Vlonë dhe shpalljen e pavarsisë.

Shllaku i mbi 20 kishave dhe i mbi 40 shpellave.


Gjeografia dhe demografia janë përmend gjansisht si krahinë midis maleve dhe përshkue nga lumi Drin. Pasunia minerale dhe bimsia, blegtoria, pyjet, klima, kullotat, të mbjellat, bimë medicinale u trajtuen si komponentët ekonomik i zhvillimit i resurseve të ardhunave të Shllakut. Burimet ujore si burime energjitike ku asht ndërtue salla e gjeneratorve të H/Centralit të Vau Dejës, që nuk përfiton ekonomia e Shllakut asnjë fitim.

Mbas ndryshimit të sistemit politik-ekonomik e ndjeu shumë edhe Shllaku, ku mbas 1992 u paralizua jeta ekonomike dhe u përqendruar kryesisht te turizmi folklorik, arkeologjik, spelologjik, kulturor, në prodhimin e gshtenjave e të tjerave.

Së fundi asht përmbyll ky libër me portretizimin në kohë të caktueme personalitete të ndryshme që kanë lanë gjurmë në jetën e sotme, në histori, kulturë e në frymzime të brezave!

Faleminderit!

NDOC PRENDUSHI,
e martë, 10 mars 2026



“Mirdita, vend i kuvendeve vetëqeverisëse” një vepër me vlera të veçanta



Prof. dr. ISMET ELEZI

Mirdita përfaqëson një nga trevat më të spikatura të organizimit vetëqeverisës tradicional në historinë shqiptare. Me një trashëgimi të pasur institucionale, kjo krahinë ka ndërtuar ndër shekuj mekanizma funksionalë të vendimmarrjes kolektive, të mishëruar në kuvendet krahinore, ku normat zakonore, autoriteti moral dhe përgjegjësia kolektive ndërvepronin për rregullimin e jetës shoqërore. Mbështetur në Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe në

praktikat vendore të kuvendimit, Mirdita u shqua si një nga trevat më të konsoliduara të vetëqeverisjes tradicionale.

Në një intervistë të vitit 2009, të botuar në librin Antologji e mendimit të sotëm për Mirditën, kam theksuar lidhjen time të hershme dhe të vazhdueshme me këtë trevë, lidhje e ndërtuar mbi përjetime personale dhe njohje të drejtpërdrejtë me realitetin historik e kulturor të saj. Këto përjetime u risollën në vëmendje me botimin e veprës së Gjon Markut “Mirdita, vend i kuvendeve vetëqeverisëse”, një studim me vlera të veçanta dokumentare dhe anali-

tike.

Kjo vepër, së bashku me kontributet studimore të Mark Tirtës dhe Pal Doçit, përbën një bazë të rëndësishme për studimin e historisë institucionale të Mirditës, duke ndriçuar strukturën shoqërore, mënyrën e jetesës dhe funksionimin e vetëqeverisjes tradicionale. Gjon Marku ka realizuar një punë kërkimore të kujdesshme, të mbështetur në burime arkivore të shumta, të cilat i ka evidencuar, sistemuar dhe analizuar sipas metodologjisë bashkëkohore shkencore.

Një nga vlerat më të spikatura të studimit qëndron në paraqitjen e plotë dhe kronologjike të korpusit të kuvendeve të mbajtura në Mirditë nga viti 1570 deri në vitin 1945. Këto kuvende nuk përfaqësojnë vetëm mekanizma të vetëqeverisjes lokale, por edhe instrumente të qëndresës politike, kulturore dhe juridike, të cilat garantuan ruajtjen e zakoneve, traditave dhe identitetit krahinor.

Në këtë vepër, Gjon Marku shfaqet si një studiues me horizont të gjerë kulturor, me korrektësi metodologjike dhe ndjeshmëri të lartë ndaj burimit historik. Kontributi i tij ndihmon në ndriçimin e vlerave shumëdimensionale të Mirditës, jo vetëm si trevë historike, por edhe si model i organizimit shoqëror në kontekstin më të gjerë të historisë shqiptare.

Në këtë kuptim, studimi plotëson dhe pasuron traditën e kërkimeve albanologjike mbi të drejtën zakonore, duke ofruar një model konkret të funksionimit të vetëqeverisjes tradicionale në një trevë të caktuar. Mirdita shfaqet si një rast studimor i rëndësishëm për analizat krahasuese të vetëqeverisjes tradicionale shqiptare dhe ballkanike.

E vlerësoj lart dhe me respekt punën e kualifikuar për programimin, evidencimin dhe sistemimin shkencor të këtij materiali, që na jep për herë të parë një paraqitje kaq të plotë dhe profesionale të kuvendeve të një treve të vetëqeverisur, me tradita të spikatura si Mirdita. Autori, përmes shfrytëzimit të burimeve arkivore dhe argumentimit të qëndrueshëm shkencor, lë mbresa të veçanta për seriozitetin dhe pasionin kërkimor.

Unë, nga Labëria, kam kënaqësinë të shprehem me respekt për këtë punë të çmuar, ku renditen për herë të parë kuvendet e mbledhura në këtë trevë nga viti 1570 deri në vitin 1945, kuvende që kishin orientim të qartë drejt qëndresës, ruajtjes së identitetit dhe mos tjetërsimit të zakonëve. “Unë e dua Mirditën ashtu siç dua Labërinë”, kam shkruar në promovimin e librave të Gjon Markut në Muzeun Historik Kombëtar, në vitin 2010.

Libra të tillë, të botuar me kujdes, pjekuri dhe seriozitet shkencor, të bëjnë ta duash dhe ta vlerësosh edhe më shumë një trevë, ta ndjesh si pjesë të kujtesës dhe të vetvetes. Gjon Marku është një punëtor i palodhur në studimin e historisë dhe kulturës së vendit të tij, të cilin e njeh thellë dhe synon ta vendosë në piedestalin që meriton.

Vepra “Mirdita, vend i kuvendeve vetëqeverisëse” përfaqëson një kontribut të rëndësishëm për historiografinë dhe albanologjinë bashkëkohore. Ajo shërben si referencë e domosdoshme për studiuesit e historisë, antropologjisë dhe së drejtës zakonore, si dhe për të gjithë ata që synojnë të kuptojnë mekanizmat e vetëqeverisjes tradicionale në hapësirën shqiptare. Është meritë e këmbënguljes, përkushtimit dhe profesionalizmit të autorit që ky botim përfaqëson një vlerë të paçmueshme për kulturën kombëtare.

Autor i librave:

Prozë

“Njeriu që vinte dhe ikte natën”, tregime (1999).

“Vari nën dardhi”, tregime (2004).

“Një natë mbret në një vend tjetër” tregime (2011).

“Mekati përtej detit” tregime (2015).

Publicistikë

“MIRDITA” (intervista) I, publicistikë (2000).

“MIRDITA” (intervista) II, publicistikë (2002).

“MIRDITA” (intervista) III, publicistikë (2004).

“Antologji e mendimit të sotëm për Mirditën” (2009).

Studime

“Në kërkim”, monografi historike (2001, ribotim me 2008).

“Mirdita në vizionin filozofik”, studim, shqip dhe anglisht (2004).

“Mirdita vend i kuvendeve Vetëqeverisëse” studim, (2013, ribotim më 2014, ribotim 2015).

Monografi

“Mënesi në kujtesë Preng Pjetër Filopati”.

“Mark Legist një jetë midis ruzhëve”.

Gjon Marku

MIRDITA

VENDI

I KUVENDEVE

VETËQEVERISËSE



Çmimi 1.000 lekë
10 euro



GJON MARKU

Lindur më 13 qershor 1967 në Gëzgj të Mirditës. Arsimi filloz dhe tërësejt, e nisi dhe e vëoi në shkollën Gëzgj, në vitet 1973-1981. Arsimi i mesëm, në shkollën e mesme Rept, Mirditë (1982-1986).

Diplomuar në:

- Universitetin Bujqësor të Tiranës, Fakulteti e agronomisë (1986-1991) Agronomi.
- Universitetin “Luigj Gurisnjaku”, Shkollë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (1992-1997). Bio-kimi.
- Universitetin Shkencor të Tiranës, Fakulteti i gjuhëve të huaja, mbrota gjuhën angleze 2010.
- Universitetin Bujqësor të Tiranës, Fakulteti i bioteknologjisë, mbrota Gradua Master 2012-2014.

Trajtuar në “Bioteknologjinë në shkollën” Pëkin, 2007.

Që nga viti 1990 ka bashkëpunuar rregullisht me shtypin periodik, gazetat: “Alternativa SD”, “Koha e jonë”, “Shkollë”, “Mirdita”, “Pena”, “Sot” etj., dhe në revistat kulturore: “Kombana e së Djalles”, “Reze Jonë”, “Kuvendi”, përkrahësit kulturor-shkencor “Shkollë në shkollë” etj. Është koleksionist, dhe studiues i filatrisë, autor i shumë shkrimeve nga kjo fushë, siç janë në revistën “Koleksionist”.

Është pjesëmarrës në disa konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit.

Ka firmuar çështjen “Pena Jonë” 2010. Përfshirë në botimin “Lidhjet e shkrimitare shqiptare”, Prishtinë, 2003, dhe “Gazetarit dhe publicistit shqiptar”, Tiranë, 2005.

Kur flasim për dijet që vijnë nga libri dhe dijet që vijnë nga interneti!



Nga SABAH LAMA

Koha e sotme, është koha kur njerëzimi komunikon dhe mer informacione të ndryshme edhe përmes internetit, krahas librave që lexon. Sigurisht për marjen e informacionit përmes internetit, shërbejnë mjetet endryshme elektronike që funksionojnë (tashmë të njohura). Pa mohuar rolin dhe domosdoshmërinë e marjes së informacionit përmes internetit, pasi hapsira që shfrytëzohet është sa e gjerë aq edhe e larmishme, dua të nënvizoj se kjo mënyrë komunikimi krahas të mirave që ka, praktika ka treguar se ka edhe të këqijat e saj nga përdorimi i tepruar apo keqpërdorimi, dhe këtu është fjala më tepër për nxënësit dhe studentët (që është edhe në fokusin e këtij shkrimi të rradhës), për brezin e ri tek i cili varet shpresa dhe e ardhmja e një kombi.

Po kush janë të këqijat e krijuara nga përdorimi i tepruar, i panevojshëm apo nga keqpërdorimi i internetit? Le t'i evi-

dentojmë si më poshtë:

– Së pari: shfrytëzimi i tepruar dhe i panevojshëm i internetit, po mënjanon përdorimin e librit dhe të teksteve mësimore që përdorin nxënësit në shkolla sipas cikleve ku ata arsimohen dhe edukohen.

– Së dyti: jo çdo informacion që ne marim nga burimet e internetit është i saktë apo shërbenë si duhet për qëllimin që kemi, pasi ka dhe raste që dija apo informacioni që marim, mund të jetë i deformuar, i cunguar apo edhe i prirur për ta shtrembëruar në mënyrë të qëllimshme një problem të caktuar që na intereson. Pra në informacionet që marim përmes internetit ka edhe dizinformime.

– Së treti në internet, përvetësimi i njohurive nga nxënësit për problemin që i intereson, bëhet në mënyrë të përgjithshme pa treguar arsyet e prejardhjes apo historikut të ndodhisë. E nisur nga ky fakt, dijet që vijnë nga interneti krijojnë konfuzion dhe pështjellim tek individ, pasi jepet vetëm të kuptuarit e përgjithshëm të problemit apo fenomenit që ndodh.

– Së katërti: mënyra e të komunikuarit vetëm përmes internetit, po na e bën nxënësindebel dhe të papërgjegjshëm për të marë njohuritë e reja që ineqviten sipas programit mësimor që zhvillojnë në shkollat ka ata arsimohen dhe edukohen sipas cikleve.

– Së pesti: e keqja më e madhe është se në vazhdimësi të përdorimit vetëm të internetit nga nxënësit, libri apo teksti mësimor, po shkon gjithnjë e më shumë drejt mënjanimit dhe eliminimit në drejtim të përdorimit. – Së gjashti lidhur me përdorimin e internetit dua të theksoj se ai mund të shfrytëzohet me tepër nga nxë-

nës dhe studentë që kanë ego dhe ambicie për zgjeruar njohuritë apo për të ditur më shumë se sa njohuritë që përmban lënda apo teksti bazë ku ata mësojnë, por kurdoherë baza apo themeli i studimit për marjen e dijeve sipas programit të lëndës që bëhet fjalë të vijë nga libri apo teksti mësimor që përdorin nxënësit sipas cikleve të shkollimit.

E njëjta gjë duhet të ndodhë edhe tek studentët që ndjekin arsimin e lartë sipas profileve përkatëse, që nesër kur të dalin në jetë, të jenë të plotësuar dhe me formimin e duhur profesional. Por në drejtim të përdorimit të vazhdueshëm të internetit, ka edhe nga ato individë që krenohen, duke menduar se shfrytëzimi i tij për marjen e informacionit, ka më shumë vlerë krahasuar me ato që marin në libra apo tekste mësimore lidhur me formimin që marin, por t'a kenë më se të qartë se janë vetëm të zhgënjyer.

Madje nxënësve dhe studentëve lidhur me përdorimin e internetit, do u thoja që atë t'a përdorni nëse duan të kenë më shumë njohuri apo të zgjerojnë njohuritë për një problem të caktuar apo për fushën ku studjojnë, por jo ta konsiderojnë internetin si një qëllim në vetvete për formimin dhe kulturën e tyre. Pra libri të jetë në rradhë të parë ai, ku ju nxënës dhe studentë, duhet të mbështeteni dhe orjentojeni për marjen e njohurive bazë qëju synoni. Dhe ja cilat janë disa nga arsyet dhe argumentat ku bazohem që dijenitë apo vlerat e informacionit që vijnë nga libri apo teksti mësimor i vlerësoji më prioritar, krahasuar me dijenitë apo informacionin që marim nga interneti:

– Së pari: teksti mësimor është mjeti

bazë didaktik për nxënësit dhe studentët, ku gjejnë informacionin e duhur për t'u formuar dhe arsimuar lidhur me objektivat që kanë për jetën e tyre në të ardhmen dhe nisur nga ky realitet, teksti mësimor bëhet më i besueshëm.

– Së dyti: tekstet mësimore hartohen nga autorë dhe specialistë të mirëfilltë që i njohin mirë problemet e profesionit që bëhet fjalë. Madje shfrytëzimin e tekstit mësimor nga nxënësit dhe studentët, do t'a vlerësoja si arterien kryesore lidhur me dijenitë që ofron për qëllime të caktuara.

– Së treti: tekstin mësimor nisur nga vlerat që ka apo dijenitë që marim, do t'a vlerësoja si çelsin apo hapin kryesor për të marë dijenitë profesionale në një lëndë apo fushë të caktuar të dijes.

– Së katërti: Dijet që vijnë nga libri apo tekstim mësimor, janë dije të konsoliduara dhe të qëndrueshme pasi fitohen përmes një stidimi gradual dhe logjik të problemit që duam të dimë. Pra analiza e problemit fillon nga rrënjët apo nga themeli, që do të thotë se kemi të bëjmë me shpjegimin e problemit dhe të asaj që duam të dimë, duke bërë fillimisht analizën e problemit, për të arritur në përfundime dhe kunkluzione të sakta dhe reale. Bie fjala për njohuritë apo dijenitë që marin nxënësit nga shkencat natyrore si : matematika, fizikë, kimi apo ndonjë lëndë tjetër e kësaj natyre, pa mohuar edhe lëndë të tjera që kanë nevojë për një përvetësim gradual dhe logjik.

– Së pesti: përvetësimi i njohurive dhe marrja e dijeve përmes studimit të teksteve, nxit te nxënësit dhe studentët të menduarit logjik për problemin që studiojnë. Pra i bën kreativ

DIJET: LIBRI APO INTERNETI?

KRAHASIMI I DY BURIMEVE TË NJOHURIVE

<div style="text-align: center; background-color: white; color: #00a68a; padding: 5px; border-radius: 10px; font-weight: bold;">LIBRI</div> <div style="display: flex; flex-direction: column; gap: 10px;"> <div style="display: flex; align-items: center;"> <div style="flex: 1;"> <p>1 BURIM BESUESHMËRIE Botime të redaktuara, autorë të specializuar, informacione të verifikuara.</p> </div> </div> <div style="display: flex; align-items: center;"> <div style="flex: 1;"> <p>2 MENDIMI KRITIK I THELLUAR Nxit analizën e thellë, kërkon përqendrim, studim sistematik.</p> </div> </div> <div style="display: flex; align-items: center;"> <div style="flex: 1;"> <p>3 QËNDRUESHMËRI E INFORMACIONIT Përmbajtja nuk ndryshon, referencë historike dhe akademike.</p> </div> </div> <div style="display: flex; align-items: center;"> <div style="flex: 1;"> <p>4 PËRVOJË TACTILE & PËRQENDRIM Mundëson shënime me dorë, më pak shpërqendrim, lexim fizik.</p> </div> </div> </div>	<div style="text-align: center; background-color: white; color: #ff9900; padding: 5px; border-radius: 10px; font-weight: bold;">INTERNETI</div> <div style="display: flex; flex-direction: column; gap: 10px;"> <div style="display: flex; align-items: center;"> <div style="flex: 1;"> <p>1 AKSESUESHMËRI GLOBALE & SHPEJTËSI Informacion i çastit, i disponueshëm 24/7, kudo ku ka internet.</p> </div> </div> <div style="display: flex; align-items: center;"> <div style="flex: 1;"> <p>2 SASIA MASIVE & SHKËMBIMI I INFORMACIONIT Mbi miliarda faqe, blogje, forume, artikuj të shumtë.</p> </div> </div> <div style="display: flex; align-items: center;"> <div style="flex: 1;"> <p>3 INTERAKTIVITET & SHUMËLLOJSHMËRI Video, kurse online, podcaste, multimedial, lojëra.</p> </div> </div> <div style="display: flex; align-items: center;"> <div style="flex: 1;"> <p>4 PËRDITËSIM I VAZHDUESHËM & HULMTIM Lajme aktuale, informacion i përditësuar, kërkim i lehtë me fjalë kyçe.</p> </div> </div> </div>
---	---

KOMBIMI MË I MIRË PËR DIJET

- Përdorni internetin për shpejtësi dhe lajme aktuale.
- Studioni librat për thellësi, analizë dhe besueshmëri.
- Verifikoni gjithmonë burimet në internet.
- Zhvilloni aftësi kërkimi kritik në të dyja platformat.

Historia jonë kombëtare, propagandistët neo - otomanë dhe historianët turq



Nikoll Loka
Historian dhe publicist

Po ta trajtojmë në mënyrë konceptuale dhe akademike qëndrimin e "historianëve" neo-otomanë që vijnë të imponojnë narrativën e tyre të pushtimit dhe sundimit të territoreve shqiptare, del se ata kanë mendësi neo-koloniale.

Ka një parim të pashkruar në studimet e traumës kolektive siç ishte dhuna osmane. Shqiptarët që kanë përjetuar atë dhunë, kanë të drejtën morale në trajtimin e përvojës së vet. Kjo nuk do të thotë monopol mbi historinë, por se nuk mund t'i imponosh nga jashtë asnjë populli dikur të pushtuar një narrativë historike që bie ndesh me kujtesën kolektive; nuk mund ta quash "çlirim" atë periudhë që pala tjetër e përjeton si pushtim. Kur kjo bëhet, perceptohet si vazhdimësi simbolike e pushtimit.

Megjithatë, jo të gjithë studiuesit turq pranojnë të kthehen në propagandistë të neo-otomanizmit. Artikulli i mëposhtëm i dy studiuesve turq është korrekt nga ana historike, brenda kuadrit të këndvësh-

trimit turk të historisë.

Bilgehan Pamuk, Fatih Sultan Mehmed Zamanında Arnavutluk (2)

B. Sehzade Mehmed dhe Arnavutlliku

Në vitin 1443, pas humbjes së ushtrisë osmane në një betejë, turqit filluan të largohen nga Ballkani. Ky zhvillim u shfrytëzua nga Iskender Beu, i cili, duke shpëtuar nga ushtria osmane, pushtoi tokat e babait të tij në veri të Shqipërisë, si Kocak dhe Akçahisar, dhe nisi një kryengritje. Kryengritja e Skënderbeut, me emrin e vërtetë Gjergj Kastrioti, u zhvillua kryesisht në veriun e Shqipërisë dhe nuk pati shumë ndikim në jug, ku sistemi timar i osmanëve ishte më i fortë, ndërsa shqiptarët e krishterë që shërbenin si spahi në këtë sistem iu bashkuan Skënderbeut. Gjatë kësaj periudhe, Skënderbeu dhe disa nga ushtarët e tij u shfrytëzuan nga komandantët e zonës së Ergliasit, si dhe nga krahinat përreth, si Zenebissi, që mund të fitonin përfundimisht.

Skënderbeu e bëri Krujën (Kroja) bazën e tij dhe ftoi princat lokalë për të diskutuar fatin e Shqipërisë. Kështu, ai shpalli pavarësinë dhe u angazhua të largonte osmanët nga tokat shqiptare. Me një ushtri prej 12 000 deri 15 000 trupash, Iskender Beu u përgatit për luftë, dhe osmanët, duke qenë të vetëdijshëm për situatën delikate në Rumeli, dërguan një komandant të njohur, Isa Beun.

Në vitin 1443, Isa Beu u nis për të sulmuar Skënderbeun.

Skënderbeu, duke përdorur taktikat e luftës asimetrike, i shkaktoi humbje Isa Beut. Shqiptarët që strehoheshin në pyje dhe zona të malore, sulmuan dhe shkaktuan humbje për ushtritë osmane. Kështjella e Svetigradit u mor nga forcat osmane, por ata humbën shumë ushtarë dhe u detyruan të tërhiqen. Isa Beu pësoi një disfatë të madhe në Krujë, dhe kjo i forcoi pozitën e Iskender Beut, i cili në një kuvend të mbajtur më 2 mars 1444 (në

Lezhë), u shpall kreu i gjithë shqiptarëve. Në këtë kuvend, princat shqiptarë dhe ata të Malit të Zi ranë dakord të paguanë taksat dhe të pranojnë autoritetin e Iskender Beut.

Në vitin 1444, Iskender Beu dha një goditje të fortë ndaj forcave osmane të komanduara nga Ali Beu, duke i shkaktuar atij humbje të mëdha. Megjithatë, pas humbjes së osmanëve, Ali Beu u detyrua të tërhiqej. Pas kësaj, Shqipëria shpalli pavarësinë dhe Iskender Beu u pranua si udhëheqës i saj. Në vitin 1445, duke mos pasur një udhëheqës të fortë si Firuz Beu, osmanët nuk mundën të angazhoheshin më shumë për situatën e Shqipërisë deri pas betejës së Dytë të Kosovës.

Aktivitetet e Skënderbeut nuk i shpëtuan syrit të osmanëve. Hamza Beu, nipi i Iskender Beut, u shpërngul në anën osmane dhe shfrytëzoi këtë për të bindur sulltanin Murad II, që të nisi një ekspeditë ushtarake në Shqipëri.

Në vitin 1448, sulltani Murad II, me djalin e tij, princin Mehmed (i ardhshëm sulltan Mehmed II), udhëhoqën një ekspeditë në Shqipëri, dhe Mehmed personalisht mori pjesë në këtë fushatë. Kjo shënoi herën e parë që Shqipëria u pushtua nga osmanët në këtë periudhë. Gjatë fushatës, osmanët morën disa kështjella të Iskender Beut, përfshirë Kocak (Svetigrad).

Sulltani Murad II ishte i vendosur të pushtonte plotësisht Shqipërinë, dhe mori qytetet e Krujës dhe Dibrës. Kur një kërcënim tjetër erdhi nga Hunyadi në Ballkan, operacionet për Shqipërinë u ndalën dhe Mustafa Pasha, nën komandën e princit Mehmed, u tërhoq në Sofje.

Pas Betejës së Dytë të Kosovës, Sulltan Murad II, me qëllim që të siguronte stabilitet në Ballkan, vendosi të nisej për herë të dytë në një ekspeditë ushtarake në Shqipëri. Ai e organizoi këtë fushatë duke forcuar kështjellat dhe shkatërruar rrugët që lidhin qytetet, për të parandaluar çdo

mundësi mbështetjeje nga jashtë. Po ashtu, ai dërgoi ushtrinë në drejtim të Venedikut. Kështjella e Krujës u forcuar në këtë periudhë. Në vitin 1450, Sulltan Murad II, për herë të dytë, u nis për në Shqipëri, dhe princin Mehmet II e shoqëroi sërish në këtë fushatë.

Kur Sulltan Murad arriti në Shqipëri, ai e rindërtoi përsëri Krujën dhe e mbajti nën kontroll. Kroja qëndroi e mbrojtur për një kohë të gjatë. Edhe kur lajmi se Jan Hunyadi po dërgonte ndihma për shqiptarët arriti, Sulltan Murad vendosi të tërhiqej për një kohë të shkurtër nga rrethimi i Krujës.

Mbretëresha e Napolit, Alfonsi V, u lidh me Iskenderbeun dhe filloi t'i ofronte mbështetje materiale. Ai i dha ndihmën e nevojshme, duke i ofruar Iskender Beut mbrojtje kundër osmanëve, pasi Alfonsi kishte ambicie për të krijuar një perandori të madhe në Mesdhe dhe mendonte se Iskender Beu mund t'i shërbente në këtë kontekst. Në mars 1451, Iskender Beu dërgoi një delegacion, përfshirë peshkopin e Krujës dhe disa priftërinj të tjerë, për të kërkuar ndihmë nga Alfonsi. Më 26 mars 1451, Skënderbeu i dha Alfonsit të drejtat e pushtetit mbi Krujën dhe atij iu premtua mbështetje për të luftuar kundër osmanëve.

Ndihma e Alfonsit e forcoi më tej pozitën e Skënderbeut në Shqipëri dhe ai arriti ta bashkonte Shqipërinë nën ndikimin e Mbretërisë së Napolit. Megjithatë, kjo i shkaktoi shqetësime Venedikut, i cili e pa me dyshim lidhjen e Skënderbeut me Napolin. Por, me rënien e Kostandinopojës në duar të osmanëve, Venediku ndryshoi politikën e tij dhe filloi të mbështesë Skënderbeun. Ky zhvillim ndihmoi që Skënderbeu të forcojë pozitën dhe të bëhet më ambicioz në lëvizjet e tij, duke kërkuar mundësi më të mëdha për të rritur ndikimin dhe pushtetin në Shqipëri.

Vazhdon...

dhe edukon tek ata krrugën e të menduarit krijues. Që nxënësit tanë sot nuk i marrin dijet përmes studimit të teksteve shkollore nga nënëvlefësimi apo braktisja e tyre, flasin edhe boshllëqet dhe mangësitë e theksuara për njohuritë dhe dijenitë që marin sipas cikleve të shkollimit. Ky fakt ka folur dukshëm edhe në testet e organizuara në nivele ndërkombëtare (Testi "PISA"), ku rezultatet e nxënësve tanë, kanë qenë në nivel mjaft të ulët, krahasuar me ato të vëndeve të tjera evropjane pjesmarrëse në të tilla teste.

Po me të njëjtin rezultat, gjithashtu kanë folur edhe rezultatet e nxënësve në provimet e maturës dhe minimaturës, që zhvillohen për çdo fund vitshkollor në vëndin tonë. Duke përfutur nga natyra e problematikës që diktojmë, gjejmë rastin të vë në dukje edhe disa nga pasojat e lin-

dura nga përdorimi i tepruar i internetit si dhe i rrjeteve sociale për qëllime të caktuara, si nga moshat e reja ashtu edhe nga ato më madhoret. Këto pasojat kanë qenë të natyrës psikologjike dhe shëndetësore.

Në këtë drejtim mund të përmendim dukuritë në vijim:

a) - Problemet apo dëmtimet e krijuara në drejtim të të shikuarit.

b) - Dalja nga vetvetënjohja kontaktet me njerëzit në jetën e përditëshme si: mungesa e vëmendjes, të komunikuarit jo normal gjatë bisedës, probleme të nervozizmit, etj.

c) - Varësia që i ka lindur individit nga shfrytëzimi i tepruar i internetit, përmes përdorimit të mjeteve elektronike (celularit apo ndonjë mjeti tjetër elektronik), ka patur si rrjedhojë edhe prirjen për t'u shkëputur nga jeta me njerëzit që e rrethojnë, nga preferenca për të bërë një jetë

të vetmuar dhe të izoluar. Për përdorimin e tepruar dhe të panevojshëm të internetit nga nxënësit dhe studentët, duke u mënjanuar nga studimi i teksteve bazë ku ata mësojnë, përgjegjësi mbajnë edhe mësuesit dhe pedagogët përkatës, sepse janë pikërisht ata që i ngarkojnë nxënësit apo studentët me detyra të caktuara dhe të panevojshme, që ka patur si rrjedhojë jo vetëm krijimin e mbingarkesës tek ata, por ka bërë që nxënësit dhe studentët të braktisin librin apo tekstin bazë ku ata mësojnë, dukuri e cila sa vjen dhe prevalon gjithnjë dhe më shumë si në jetën shkollore, ashtu edhe në atë universitare.

Së fundi dua të nënvizoj se nga të tilla angazhime që u bëhen nxënësve dhe studentëve, duke shfrytëzuar së tepërmi internetin për lëndët që u zhvillojnë, jo vetëm që mësuesit dhe pedagogët janë përgjegjës që i kanë edukuar me këtë

rrugë, por në në gjirin e tyre ka edhe nga ata mësues që abuzojnë, duke i'u shmanjur punës së tyre lidhur me shpjegimin e lëndëve që mbulojnë, pra që nuk kryejnë detyrën që u takon, ndonëse për këtë punë paguhen.

E sigurisht të tillë mësues apo pedagogë lidhur me sjelljen që manifestojnë duke mos kryer si duhet detyrën, meritojnë edhe të ndëshkohen nga organet përkatëse të arsimit, pasi nuk u dalin borxhit nxënësve apo studentëve lidhur me shpjegimin e lëndës dhe profesionit që ushtrojnë si mësimdhënës dhe edukator. Është pikërisht edhe kjo një nga arsytet kryesore që nxënësit e shkollave si dhe studentët kur dalin në jetë, kanë boshllëqe dhe mangësi të theksuara lidhur me dijenitë dhe formimin e tyre për profesionin që kanë mbaruar.

Pjetër Guraziu nga Shkodra

Pjetër Guraziu nga Shkodra, është rekordmeni i parë të atletikës shqiptare, me rezultatin 6.15 metra, më 11 prill 1925 në Bari të Italisë.../ Refleksionet e gazetarit të njohur të sportit shqiptar

Nga BESNIK DIZDARI

Për ndokënd ndoshta mund të duket si diçka e habitshme: një martir që është edhe rekordmeni i parë i sportit të një kombi! Në të vërtetë, në këtë titull të këtij shkrimi apo në këto tetë fjalë të tij, gjithçka është sa e natyrshme, po aq dhe e vërtetë. Ndonëse ajo sapo vërtetohet përmes këtij tregimi të herës së parë të këtij viti 2018. E çuditshme është se si ka qenë e mundur që deri më sot, më 2018 pra, kjo e vërtetë ka mbetur e panjohur, e pa ditur, e pa fiksuar. E prapë nuk duhet të çuditemi. Historia në Shqipëri, ajo e sporteve në veçanti, ende ecën tejet ngadalë, si diçka e dorës së dytë, me të pavërteta të pafund, me tregime naive, me shpërndarje afirmimesh, të pamerituara madje. Deri aty, sa një historiani profesionist të ndershëm, i duhet veç të ndreqë pa ndalë sjelljet brutale të shkruarve të pandërgjegjshëm, të cilët për çudi vazhdojnë të mbushin faqet e gazetave.

“Shqipëria komuniste është i vetmi vend në Evropë, e cila ka pushkatuar tre rekordmenë të saj, në sportin e atletikës së lehtë; Biçaku, Guraziu dhe A. Këllezi...”

Refleksionet e gazetarit të njohur sportiv

Kur rekordi botëror ishte 7.76 m. mbatur prej amerikanit Robert LeGendre. Nuk po mbërrimë deri në këtë krahasim. Por 6.15 m. prej një shqiptari, kur atletika e lehtë në Shqipëri ende nuk kishte dalë në pistë apo pedanë, sot do konsideruar më se i jashtëzakonshëm. Ky është ishte viti i atletikës së Pjetër Guraziut nga Shkodra e Shqipërisë, i cili në të vërtetë, me tufën e diplomave që zotëron familja Guraziu, të duket se kemi të bëjmë me një atlet të shumëgarëshit. Ai ka diplomë fituesi edhe në kërcimin së larti, në vrapimin e 100 metrave apo dhe në 3000 metra. Shqipëria e vitit 1925 kishte përcaktuar rekordmenin e saj të parë, ende pa mbërritur atletika kampionate në tokën e saj.

Për këtë do të duheshin edhe 4 vjet të tjera. Do të duhej kësisoj, që edhe Shqipëria të mbërrijë te Kampionati i saj i Parë Kombëtar i Atletikës së Lehtë: 2 shtator 1929. Çudia është se jemi një vit para 6 qershorit 1930, të themelimit zyrtar të atij organizimi që do të quhej Enti Kombëtar “Djelmnia Shqiptare”. Është ky Ent, ai që më 20 gusht 1929, nis e organizon me atletikën Kampionatet Kombëtare. Drejtori i Entit, Prof. Giandomenico De Marchis, i cili do të luajë role të dorës së parë në organizimin e kampionateve tona kombëtare të viteve ’30-të, deklaron ndërkaq, se:

“Kemi nderin t’ju njoftojmë se si mbas urdhënit të N.M. së Tij Mbretit të Shqiptarëve Zog I, me dekret, më 2, 3, 4, 5, 6 shtator të këtij viti kanë me u zhvillue këtu në Tiranë, nën ditët e naltshenjueme, të parat Gara të Kampionateve t’ Atletikës së Lehtë, t’ organizueme nga kjo degë. Garat në fjalë kanë me u zhvillue në fushën e Shallvares”.

Ky ishte njoftimi. Një njoftim i madh historik, sepse ishte fjala për Kampionatin e parë sportiv që organizonte Shqipëria, madje saktësisht një vit para Kampionatit Kombëtar të Futbollit (1930). Atletika e lehtë është pionierja e Kampionateve Kombëtare të Shqipërisë. Dhe siç kam shkruar me kohë, është një organizim vërtetësisht perëndimor për kushtet modeste të shtetit të ri të Shqipërisë, vetëm 17 vjet mbas pavarësisë së saj. Është një Kampionat i Parë Kombëtar i Atletikës së Lehtë, që ka mbushë Tiranën me pllakatën e tij dhe që zhvillohet nën “patronazhin e naltë të Princeshës Myzejen”.

Dhe një tufë shënjash trofe: Kupa të rralla dhe elegante për fituesit vetjakë dhe ekiporë, që zbukurojnë publicitetin e shtypit, teksa tregohen para fillimit të Kampionatit. Ministri i Arsimit, Hil Mosi, merret personalisht me këtë Kampionat.

Dhjetë vjet më parë, më 1919-ën, ai kishte qenë organizatori kryesor dhe kryetari themelues i asaj që njihet deri sot e kësaj dite, si Shoqnia “Vllaznia” e Shkodrës, prej ku vjen “Vllaznia” e sotme, ajo shoqëri kulturore sportive, e cila më 1920 kishte organizuar garën e parë atletike në Shqipëri, një maratonë e vogël rrugëve të Shkodrës, të fituar prej të quajturit Kole Gjoni.

Pa dyshim, kjo ndjesi atletike e atdhetarit të shquar, tash ministër, ka pasur rol parësor edhe në këtë organizim të Kampionatit Kombëtar të Atletikës së Lehtë. Kështu mbërrihet te 2 shtatori 1929. Në “Shallvaren” e Tiranës. Ceremoni e shkëlqyer për kohën. Rreshitim. Parakalim, Himn Kombëtar. Prani e Princeshës Myzejen, fjala emocionuese e prefektit Rexhep Jella. Shqipëria kishte themeluar jo thjesht Kampionatin e Parë të Atletikës së Lehtë pra, por vetë atë që kemi thënë qysh në krye të këtij tregimi historik: themelimin e Kampionateve Kombëtare të Shqipërisë për gjithë sportet.

Nuk gaboj kur them se është data më historike themeluese në krejt jetën e sporteve në Shqipëri. Dhe ja tek shfaqet kampioni i parë i Kampionatit, si dhe rekordi i parë kombëtar në historinë e Shqipërisë. Kjo ngjet në kërcimin së larti nga i mirënjohuri Prof. Peter Andoni i Elbasanit me 1.68 metra, një sportist i gjithanshëm qysh në “Robert College” të Stambollit. Është pikërisht ky njeri që lidhet në largësi me personazhin tonë Pjetër Guraziu. Andoni është njeriu, i cili thuhet se sundon Kampionatin e parë të Shqipërisë. Kampion në kërcimin së larti, në kërcimin së gjati, por dhe në pesë-garash dhe dhjetë-garash.

Është i vetmi që rrëmben katër medalje të arta të Kampionit të Shqipërisë! Dhe ne që i veçojmë garën e protagonistit “tonë”, atë të kërcimit së gjati. Andoni shpal-

let Kampion Kombëtar me shifrat 5.97 metra, që deri më sot, mbasi jam lodhur tejet me arkivin, e kemi pranuar edhe si rekordin e parë të kërcimit së gjati. Çka do të thotë plot 18 centimetra më pak nga rekordi i Guraziut (6.15) i Barit të vitit 1925. Tash, na duket sikur sot mbas gati një shekulli, ne po i ftojmë dy rekordmenët në një garë virtuale, që më shumë se në pedanën e kërcimit ajo “zhvillohet”



Filip Pjetër Guraziu, fitues i Medaljes së Arte, në Spartakiadën sportive të parë Kombëtare, në vitin 1929

midis dokumenteve e faqeve të shkruara të historisë.

E edhe në largësi kësisoj, midis profesorit të “Robert Cellegge” të Stambollit, Peter Andonit dhe doktorit në ekonomi të Universitetit të Barit, Pjetër Guraziu, vetëviti dueli i tyre virtual nis dhe mbaron me tregimin tonë, të cilin më poshtë do ta mbyllim pikërisht me rregullimin historik të këtij rekordi të panjohur deri më sot. Nja 4-5 vjet më parë, në një shkrim historik për atletikën e lehtë, kam rreshtuar këto emra:

Llazar Miha, Ragip Lohja, Sabit Çoku, Prof. Peter Andoni, Mehmet Gjakova, Vasil Alarupi, Simon Todoshi, Jorgji Koja, Prof. Taho Shkreli, Prof. Adem Karapici, Qamil Abazi, Irfan Gjinali, Ferid Beshiri, Vladimir Shuteriqi, Irfan Gjinali, Prof. Ibrahim Dizdari, Mitat Aranitasi, Ahmet Karini, Muhamet Agolli, Rexhep Maçi, Qamil Abazi, Ahmet Duhaxhiu, Vladimir Shuteriqi, Hysen Kusi, Prof. Behxhet Jolldashi, Qazim Dervishi, Dr. Bahri Koplaku, Ahmet Taibi, Zeqir Sulejmani, Dr. Isuf Dashi, Andrea Çani, Shaban Ahmeti, Dr. Naim Vreto, Qazim Keçiçi, Prof. Xhevdet Skilja, Dr. Ndoc Gera, Qamil Abazi, Mehmet Gjakova, Ing. Llazar Miha, Aleko Turtulli, Ahmet Duhaxhiu, Taho Shkreli, Rifat Jolldashi, Koço Kaftani, Azbi Tepelena, Fetah Fara, Aleko Turtulli, Rexhep Shpendi, Andon Terova, Petraq

Leka, Ndoc Paci, Muharrem Toptani, Shuk Radoja, Kapllan Dervishi, Av. Sandër Kraja, Shadan Toptani, Jorgji Koja, Ymer Sharra, Prof. Elez Maha, Isa Meta, Kristo Isak, Prof. Alush Lleshanaku e Muharrem Musa.

Të gjithë janë pjesëmarrës të Kampionatit të parë të Atletikës së Lehtë 1929, por një pjesë e mirë edhe të atij 1930. Kampionë, nënkampionë dhe medalistë “të bronzte”, siç mund t’i quajmë. Por mua më ka shpëtuar një emër:

Pjetër Guraziu.

Më 1929, ai është ende në Bari, por më 1930, ai është pjesëmarrës i Kampionatit të Dytë Kombëtar të Shqipërisë në Atletikën e Lehtë. Ma zbulon rishikimi i arkivit tim të vjetër. Dhe gara e kërcimit së gjati për këtë Kampionat, thuhet se gjitha është e “markës shkodrane”.

Në të vërtetë është dueli Qazim Dervishi – Pjetër Guraziu. Kampion është universali i themelimeve të sporteve shqiptare, Qazim Dervishi, me 6.04 m, ndërsa nënkampion është Pjetër Guraziu me 5.93 m. Ata lënë në vendin e tretë as më pak e as më shumë, por njeriun me emrin e shquar Selman Stërmasi. Dhe çudia e madhe. Nënkampioni Guraziu shkon dhe merr pjesë në hedhjen e diskut, ku renditet i treti.

Mandej lë për në fund pjesëmarrjen në stafetën 4x100 metra ku së bashku me Luigj Shalën, Luigj Radojën dhe Sandër Krajin, fitojnë titullin e Kampionit të Shqipërisë. Kështu, krejt papritmas mbasi zbulojmë Pjetër Guraziun si rekordmenin e parë të Shqipërisë në kërcimin së gjati, si nënkampionin e Shqipërisë më 1930, po në kërcimin së gjati, gjejmë edhe Pjetër Guraziun si Kampion të Shqipërisë në stafetën 4x100 metra. Një sportist i plotë, rekordmen

dhe kampion i vendit të tij. Dhe vitet që bëjnë të tyren. Lë pistën dhe pedanën, por jo veprimtaritë e mjedisit sportiv. Tash në funksione të reja...!

Nga libri që kam shkruar për jetën sportive të jashtëzakonshmit Dr. Vasfi Samimit, shkëpus këto radhë: “... Më 13 gusht 1935 në mbledhjen e përgjithshme të përfaqësuesve të shoqërive sportive e artistike jashtëshkollore, duke u bazuar në nenin 382 të Shkollimit, themelohet në Tiranë Federata e Shoqërive Sportive e Artistike me emrin ‘Vllaznija Shqiptare’...! Nën drejtimin e matur e përparimtar të Mirash Ivanajt, Federata ‘Vllaznija Shqiptare’ forcohet tejet dhe roli i saj në përforcimin e kampionateve kombëtare të futbollit, atletikës, notit e çiklizmit, do të vinte bazat e një organizimi sportiv më të përsosur...!

Ndërkaq, Federata Sportive Shqiptare, e mbas saj edhe ‘Vllaznija Shqiptare’, themelojnë Këshillin Teknik Arbitral Shqiptar, i cili ka në duart e tij, gjithë udhëheqjen tekniko – organizative të sportit shqiptar. Nëse do të kërkonim të krahasonim me tipet e organizimeve të sotme të lëvizjes sportive, do të thoshim pa ngurrim se Komiteti Teknik Arbitral Shqiptar (KTASH) ka qenë një lloj Komiteti i Kulturës Fizike të Sporteve, që ka sunduar Shqipërinë e mbas luftës për vite të tana...! I pari KTASH i sapo themeluar përbëhet

nga organizatori anglez i xhandarmërisë shqiptare, Nënkolonel Oakley Hill, Luigj Shala, Eqrem Stërmasi, Dr. Pjetër Guraziu, Dr. Vasfi Samimi, Telemak Nushi"...!

Kjo, si të thuash, është jeta e dytë sportive e Dr. Pjetër Guraziu. Edhe në këtë rast, ai është një themelues. Një prej gjashtë themeluesve të drejtimit të sporteve në Shqipëri. Njëri më i shquar se tjetri. Njeri më intelektual se tjetri. Mandej, kur mbërrin te Mbas-lufta, që do t'i merrte jetën në kulmin e pjekurisë, aftësive dhe kontributeve të tij kombëtare, ndonëse më pak, ai do të jetë përsëri në role drejtuese sportive. Lojërat Ballkanike të vitit 1946 – një ndërmarrje evropiane mund të themi për Shqipërinë – do të duhej të kishin edhe praninë e tij.

Pjetër Guraziu është në jurinë drejtuese të garave e ndeshjeve pranë figurave të shquara të huaja ballkanike, si Juan, Tucan, Lupan, Hristof, Sherbo, Brancev, Nesku e Fiork, si dhe e kolegëve të tij të shquar shqiptarë. Guraziu pra, por dhe Zajmi, Karapici, Skilja, Hila, Naqi, Lisi, I. Dizdari, Domini, Maha, Rama...! Lojërat Ballkanike duhet të kenë qenë ndarja përfundimtare e Pjetër Guraziu nga jeta e tij sportive në shërbim të atdheut. Do t'i mbeteshin edhe gjashtë vjet për të mbyllur tragjikisht jetën e tij të jashtëzakonshme në shërbim të atdheut të tij.

Tash, duke qenë të bindur se kjo histori e treguar këtu, assesi nuk mund të ketë një fund të gëzuar, kur mendon se në çfarë tragjedie do të përfundonte martiri Pjetër Guraziu, po e mbyllim duke kërkuar disi një lloj qetësimi që na mbart pesha tërheqëse e historisë sportive. Në këtë rast do të vëmë në pedestalin e një historie, për ne të rrallë, emrin e martirit rekordmen Pjetër Guraziu. Dhe gjithçka vjen e bëhet krejt e thjeshtë, ndonëse prapë kufijtë kronologjikë të rekordit kombëtar të Shqipërisë, në një nga garat më spektakolare të atletikës së lehtë, siç është kërcimi së gjati, do t'i përkasin po qytetit që lindi Pjetër Guraziun, Shkodrës.

Qytetit, që ashtu siç i kishte dhuruar Shqipërisë shoqërinë e parë sportive ("Vlaznia", me 1919), vrapimin e parë atletik (1920), Rrethin e Parë Çiklistik (1925), i kishte sanksionuar edhe rekordmenin e parë sportiv (Pjetër Guraziun, me 1925). Historia kronologjike e rekordit shqiptar të kërcimit të së gjati, në të vërtetë është tejet origjinale dhe gjithnjë me kthesa të bujshme.

Një histori që deri më sot kishim menduar se niste me Peter Andonin – 5.97 m., më 1929, por tash falë dokumenteve autentike të sportistit të madh të Shqipërisë Filip Guraziu, birit të martirit Pjetër Guraziu, zbulojmë rekordmenin e parë të atletikës shqiptare, në të vërtetë rekordmenin e parë për krejt sportin shqiptar.

Është 6.15 metra më 11 prill 1925 në Bari të Italisë. Këtu është themeli. Këtu është nisja. "Errata corrige", do të bëhet duke vendosur rekordmenin e dytë Peter Andonin me 6.16 metra më 1930. Dhe më mbas të tjerët që vazhdojnë me Selman Stërmasin, e duke u pasuar prej një rekordi kulmor për kohën, atë të Sabit Çokut me 6.58 metra. Çka për Shqipërinë sportive duhej të kalonin plot 21 vjet dhe të vinte viti 1956, e bashkë me të nga Shkodra të mbërrinte një djalë 22-vjeçar



Pjetër Guraziu gjate garës atletike, në Shkodër, në vitin 1914

si Hysni Bebeziqi i "Partizanit", që ta thyente këtë rekord çerekshekullor. Ai mbërrin në 6.63 metra, pra vetëm me 5 centimetra më tepër.

Ka qenë një ditë e vitit 1956 dhe Shqipëria Komuniste e Sportit kaloi në eufori, sepse më në fund u thye edhe një rekord që mbahej prej një "borgjezi" me emrin Sabit Çoku, i cili përveç të tjerave, ishte vëllai i një "tradhtari" në emigracion, siç e përcaktonin pa mëshirë Prof. Mentor Çokun e nderuar. Të duket se edhe për nderin e rekordmenit të parë Pjetër Gura-

ziut, gara e kërcimit së gjati ka mbërritur te maja e saj për atletikën shqiptare.

Në të vërtetë janë katër maja: rekordi i parë i Pjetër Guraziu, rekordi rezistues i 21 vjetëve i Sabit Çokut, rekordi përmbyës i Hysni Bebeziqit dhe kulmi evropian i atletit të sotëm po nga Shkodra, Izmir Smajlaj – Kampioni i Evropës në salla të mbyllura me shifrat e nivelit botëror 8.08 metra. Është pikërisht kërcimi së gjati që i dha Shqipërisë Kampionin e parë të Evropës në sportin e atletikës së lehtë, qoftë dhe në sallë, një rezultat krejt i afërt edhe



Për të tretën here kampion Kombëtar në basketboll, në vitin 1963. Nga e majta në të djathtë: Mjeshtri i Madh Bujar Shehu e Vaso Shaka dhe Kalorësi i Urdhrit të Flamurit Filip Guraziu.



Pjetër Guraziu, në vitin 1925, viti i rekordit në kërcim s' gjati 6.15 m, 19 vjeç

me atë 8.03 metra çka ndërkombëtarin ynë Smajlaj, ka arritur në pedanën e hapur, aty ku gjithçka nis me rekordmenin e parë, Pjetër Guraziun. Historia është kjo:

Historia kronologjike e Rekordit në Kërcim së gjati 1925 – 2018:

- Bari, 11.04.1925
- Pjetër GURAZIU 6.15 m.
- 1930 Peter ANDONI 6.16 m.
- 1932 Selman STERMASI 6.27 m.
- 1934 Sabit ÇOKU 6.38 m
- 1935 Sabit ÇOKU 6.58 m.
- 1956 Hysni BEBEZIQUI 6.58 m.
- 1956 Hysni BEBEZIQUI 6.63 m.
- 1957 Hysni BEBEZIQUI 6.69 m.
- 1957 Hysni BEBEZIQUI 6.89 m.
- 1959 Hysni BEBEZIQUI 6.99 m.
- 1961 Sabaudin RAMKU 7.04 m.
- 1964 Sabaudin RAMKU 7.14 m.
- 1970 Koço MULLA 7.15 m.
- 1971 Koço MULLA 7.30 m.
- 1975 Arben PAPULI 7.34 m.
- 1979 Gjergj RULI 7.64 m.
- 1984 Gjergj RULI 7.70 m.
- 2007 Admir BREGU 7.71 m.
- 2008 Admir BREGU 7.75 m.
- 2014 Izmir SMAJLAJ 7.75 m.

- Tiranë. 25.06.2014,
- Izmir SMAJLAJ 7.78 m.
- Elbasan. 21.05.2016,
- Izmir SMAJLAJ 8.03 m.

Dhe këtu, nën këtë pamje, duket se kulmon edhe kjo histori kronologjike, tash edhe më e pasur se kurrnjihërë. Ajo i bën nder vërtetësisë, ndryshe sanksionimit të vërtetës historike të atletikës shqiptare dhe saktësisë të historisë së sportit shqiptar që fillon me martirin Pjetër Guraziu. E, vetvetiu po më vjen për shtat ta mbyll këtë sagë tragjiko-dramatike, me këtë përcaktim shembullor (emblemantik) të të madhit Curzio Malaparte, i cili thotë: "Diktatura është forma më komplekse e xhelozisë". Ndonëse në rastin e tregimit tonë, ajo ishte dhe forma më e qartë e shtypjes më të pamëshirshme. Për fat, deri në krim!...

Paraqiti për botim
FILIP GURAZIU

Robert Elsie

FIGURA MË E RËNDËSISHME NDËRKOMBËTARE
E STUDIMEVE PËR KULTURËN VERIORE SHQIPTARE

Studimet albanologjike kanë njohur një zhvillim të rëndësishëm gjatë shekullit XX dhe XXI, por figura që qëndron më e veçuar ndër ta është padyshim ajo e studiuesit kanadez-gjerman Robert Elsie (1950–2017). Me formim gjuhësor, filologjik dhe kulturor të thelluar në disa universitete evropiane e amerikane, Elsie i kushtoi gati pesë dekada kërkimi shkencor: gjuhës shqipe, letërsisë shqiptare dhe historisë kulturore të popullit shqiptar.

Edhe pse ai studioi të gjithë hapësirën shqiptare, është Veriu i Shqipërisë që zë qendrën e gravitetit të veprës së tij. Ky rajon, me tradita të lashta, me kulturë të veçantë, me organizim fisnor, me epikë heroike dhe me trashëgimi gojore unike në Ballkan, u bë terreni ku Elsie zhvilloi disa nga studimet më të rëndësishme të karrierës së tij. Vepra e tij përfshin përkthime monumentale, si ato të Këngëve të Kreshnikëve, studime të thelluara mbi fiset e Veriut, botime dokumentare, mbi Kanunin e Lekë Dukagjinit, si dhe analiza të teksteve të vjetra të klerit katolik shqiptar.

Interesimi i Elsiut për Veriun nuk ishte thjesht akademik, por shpeshherë edhe personal e emocional. Ai udhëtoi shpesh në Mirditë, Malësinë e Madhe, Tropojë, Dukagjin (Shalë, Shosh, Pult dhe Theth), duke u lidhur drejtpërdrejt me bartësit e traditës popullore. Madje, testamentarizoi që pas vdekjes eshtrat e tij të varroseshin në Theth, një vend që ai e konsideronte “një nga thesaret më të pastër të kulturës shqiptare”.

Nëpërmjet veprës së tij, Robert Elsie u bë një urë lidhëse mes kulturës veriore shqiptare dhe botës akademike ndërkombëtare. Ai arriti të prezantojë për herë të parë në mënyrë të plotë dhe të sistemuar epikën, kodet tradicionale, strukturën shoqërore dhe letërsinë e Veriut të Shqipërisë, për një publik të gjerë global. Për këtë arsye, studimi i kontributit të tij është thelbësor për të kuptuar pozicionin e kulturës veriore në mozaikun e identitetit shqiptar.

Por le të ndalemi pak më gjerë në: jetën dhe formimin shkencor të Robert Elsiut; lidhjet e tij personale dhe profesionale me Veriun e Shqipërisë; kontributin e tij në studimin e epikës, fisnikërisë, traditave dhe letërsisë veriore; ndikimin dhe rëndësinë e veprës së tij në albanologji dhe në prezantimin ndërkombëtar të kulturës shqiptare.

Në këtë kuadër, punimi përqipet të paraqesë jo vetëm analizën e ndikimit të tij shkencor, por edhe dimensionin kul-

turor e simbolik që lidhi këtë studiues me një nga zonat më të pasura dhe më të veçanta të identitetit kombëtar shqiptar.

Robert Elsie lindi më 29 qershor 1950, në Vancouver, Kanada, në një familje me rrënjë gjermane. Qysh në moshë të re, ai tregoi interes të theksuar për gjuhët, kulturat e ndryshme dhe letërsinë. Kjo prirje intelektuale do ta çonte më vonë drejt studimeve të thelluara në fushën e gjuhësisë, filologjisë dhe historisë së kulturës evropiane.

Gjithmonë i pasionuar pas kulturave të veçanta, ai do të shprehte më vonë se ishte i tërhequr nga Shqipëria pikërisht për shkak të “unikalitetit të saj gjuhësor, kulturor dhe historik”, i cili e dallonte nga vendet e tjera të Ballkanit.

Elsie kreu studime të gjera në disa universitete prestigjioze të Amerikës së Veriut dhe Europës Perëndimore.

Studimet bazë dhe master: University of British Columbia (Kanada) – Gjuhësi dhe Gjuhë-Letërsi Gjermane. McGill University (Montreal) – Gjuhësi krahasuese dhe filologji. Gjatë këtyre viteve ai u pajis me një bazë të gjerë teorike, të cilën më vonë do ta përdorte për të analizuar dhe interpretuar zhvillimet fonetike, morfologjike, leksikore dhe historike të gjuhës shqipe. Studimet pasuniversitare dhe specializimet: Universiteti i Bonnit (Gjermani). Free University of Berlin. Sorbonne – University of Paris. Në këto institucione ai u specializua në: Gjuhësi historike, Gjuhët ballkanike, Gjuhët kelte, Filologji krahasuese, Letërsi të Evropës Lindore. Këto studime formësuan metodologjinë e tij shkencore, gjithmonë të mbështetur në analiza krahasuese, kritikë të burimeve dhe dokumentim të detajuar.

Interesi i tij për Shqipërinë nisi në fillim të viteve 1970. Ai erdhi në Shqipëri si pjesë e një delegacioni akademik gjerman, në kohën kur vendi ishte i izoluar politikisht dhe kulturor. Ajo vizitë e parë u bë pikënisja e një lidhjeje që do të zgjaste për gjithë jetën.

Gjatë këtij udhëtimi: filloi studimin sistematik të gjuhës shqipe, u njoh me shqiptar, veçanërisht atë verior, u mahnit nga izolimi i thellë i kulturës malësore, e cila i dukej si “një dritare e hapur drejt Mesjetës së gjallë”.

Elsie kuptoi se tradita gojore shqiptare - dhe veçanërisht epika veriore - ishte një pasuri unike që kërkonte dokumentim dhe analizë të kujdesshme shkencore. Kjo do të vinte bazat e lidhjes së tij të pandashme me Veriun.

Gjatë pesë dekadave të punës shkencore, Robert Elsie botoi dhjetëra libra për kulturën, historinë dhe letërsinë shqiptare; përktheu autorë shqiptarë nga Mesjeta deri te moderniteti; u bë autoritet ndërkombëtar në albanologji; mbajti leksione në shumë universitete evropiane dhe amerikane; punoi si ekspert për Organizatat Ndërkombëtare, sidomos pas viteve 1990 në Kosovë dhe Shqipëri; themeloi biblioteka digjitale me tekste të vjetra shqipe dhe dokumente historike.

Reputacioni i tij akademik u forcua sidomos pas botimeve: Albanian Literature – A Short History, Historical Dictionary of Albania, The Tribes of Albania, Songs of the Frontier Warriors, Këto vepra janë sot materiale bazë për kërkuesit e huaj dhe shqiptarë.

Robert Elsie u veçua për disa arsye: Ai ishte shkencor dhe i paanshëm. Nuk mori pozicione politike, por analizoi fenomenet kulturore në mënyrë neutrale, duke përdorur metodologji perëndimore. Ai solli kulturën veriore shqiptare në botë.

Përkthimet e tij të epikës dhe studimet mbi fiset e Veriut janë sot referenca ndërkombëtare. Ai ishte një katalizator i ruajtjes së trashëgimisë. Dokumentoi këngëtarë, rapsodë, pleq dhe bartës të traditës së Veriut në kohën kur kultura gojore po rrezikonte zhdukjen. Ai punoi me pasion, jo thjesht profesion. Për Elsiën, Shqipëria - dhe sidomos Veriu - ishte “shtëpia shpirtërore”.

Robert Elsie ndërroi jetë më 2 tetor 2017, në Berlin. Dëshira e tij e fundit ishte që hiri i trupit të tij të shpërndahet në Theth, një nga zonat më ikonike të Veriut të Shqipërisë. Ky akt simbolik tregon lidhjen e tij të thellë emocionale me kulturën malësore, e shndërron figurën e tij në pjesë të përhershme të identitetit verior, bën që studimet e tij të shihen jo vetëm si punë shkencore, por edhe si përkushtim personal.

Robert Elsie udhëtoi për herë të parë në Shqipëri në fillim të viteve 1970, në një kohë kur vendi ishte i izoluar. Pas vizitës së tij fillestare në Tiranë, ai u tërhoq veçanërisht nga Veriu i Shqipërisë, një rajon i cili, ndonëse i varfër dhe i ndarë gjeografikisht, ruante një pasuri të jashtëzakonshme të kulturës tradicionale shqiptare. Elsie e përshkruante Veriun si: “Vend ku historia ecën krah për krah me të sotmen, dhe ku e shkuara nuk është thjesht kujtesë, por mënyrë jetese.” Kjo përshtypje e parë u bë motiv kryesor i një jete të tërë kërkimesh.

Gjatë 40 viteve të mëvonshme, Elsie e vizitoi Veriun dhjetëra herë. Ai udhëtoi në: Theth, Valbonë, Tropojë, Malësinë e Madhe (Kelmend, në veçanti në Vermosh), Mirditë, Dukagjin, (Shalë, Shosh e Pult, Shllak e Temal), Lugina e Valbonës, zonat e ish-fiseve të mëdha shqiptare. Gjatë këtyre udhëtimeve, ai jo vetëm që studioi, por edhe jetonte mes banorëve lokalë. Flinte në shtëpitë e tyre, dokumentonte këngë, bisedonte me pleq, rapsodë,

klerikë, prijës fisnorë dhe bartës të traditës. Ky kontakt i drejtpërdrejtë i hapu atij horizontin për të kuptuar nga afër: botën shpirtërore të malësorëve, etikën e tyre, mënyrën e jetesës sipas Kanunit, rolin e epikës si memorie kolektive, ritet dhe traditat e pashkrutuara

Ka disa arsye pse Elsie u identifikua që shumë me Veriun: Veriu ruante gjurmë të kulturës së vjetër shqiptare. Ndryshe nga shumë rajone të tjera të Ballkanit, Veriu mbante ende gjallë epikën, këngën e lahutës, strukturat fisnore dhe zakonet e të drejtës tradicionale. Veriu ishte më pak i dokumentuar. Shumica e studiuesve të huaj kishin hulumtuar Toskërinë (sidomos periudhën e Rilindjes), ndërsa Veriu kishte një boshllëk të madh studimor. Kjo e tërhoqi Elsiën. Epika dhe legjendat e Veriut kishin vlera të jashtëzakonshme dokumentare. Këngët e Mujit dhe Halilit, baladat dhe legjendat ishin “arkiva të gjalla të historisë së hershme shqiptare”. Veriu ofronte autenticitet kulturor. Elsie thoshte se në Veriun e Shqipërisë gjen një kulturë që i shpëtoi ndikimeve të shumta dhe ruajtja ADN-në e traditës shqiptare.

Elsie krijoi lidhje të forta me: rapsodët e lahutës, kënduesit e eposit, klerikë katolikë në Shkodër, Mirditë dhe Malësi, pleq të fiseve veriore, familje të njohura malësore, të cilat i hapën arkivat e tyre të dorëshkrimeve. Ai shpesh regjistronte këngë të rralla, që sot nuk këndohen më. Këto regjistrime përbëjnë një thesar të paçmuar të trashëgimisë gojore shqiptare, i cili falë tij u ruajt. Në shumë raste, banorët e Veriut e pranonin Elsiën si pjesë të bashkësisë. Ai vetë shpesh e quante veten “mik i përhershëm i maleve”.

Elsie ishte një nga të paktët studiues të huaj, që u ul në “gryqet e pleqve”, ku zgjidheshin konfliktet sipas Kanunit. Ai dokumentoi: strukturën e pleqve, mënyrën, e vendimmarrjes, rolin e fjalës së dhënë, kodin e nderit, mënyrën e pajtimit

Këto vëzhgime të drejtpërdrejta i përdori më vonë në analizat e tij shkencore, duke i dalluar: elementet që i përkasin traditës së vërtetë, nga keqinterpretimet moderne të Kanunit.

Kleri katolik, në veçanti Françeskanët, luan rol kyç në kulturën veriore. Elsie bashkëpunoi me shumë prej tyre, duke hyrë në arkiva të: Kuvendit Françeskan, Arkivit Dioqezan të Shkodrës, Kishave të veriut, Arkivave private të priftërinjve, Ai gjeti dhe digjitalizoi dorëshkrime të: Buzukut, Budit, Bogdanit, Gjeçovit autorëve anonimë të shekujve XVII–XIX. Këto materiale i shërbyen për të ndërtuar një panoramë të plotë të letërsisë së vjetër veriore.

Elsie u bë urë lidhëse: ndërmjet kulturës së Veriut dhe akademisë botërore.

Ai shkroi në anglisht për: epikën shqiptare, traditat e fiseve, zakonet, letërsinë e vjetër të Veriut, figurat historike të malësisë. Kjo e bëri kulturën veriore të kuptohet dhe vlerësohet jashtë kufijve të Shqipërisë. (vijon në numrin e ardhshëm)

REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj
Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,
Suela Ndoja, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia
Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja,
Vilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza,
Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

**MUNDËSOI BOTIMIN:
Major VASIL ÇUNI,
Drejtor i Departamentit
të Sigurisë së Personelit.**

